

128 / 47.

17.09.2019.


RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Bsc 'Financë - Bankë,

Ofruar nga Universiteti Privat "Albanian University"

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

1. Prof. Dr Sherif BUNDO
2. Dr. Dritan FINO



(Tiranë, Shtator 2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSc Financë- Bankë

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Albanian University
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASH Nr. 8981, datë 27.12.2005
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë Urdhëri/VKA e Akreditimit të dytë	UMASH Nr. 541, datë 01.12.2010 VBA Nr 85, datë 21.09.2017
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor Financë-Bankë
6	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vjet
8	Kreditet në total (ECTS):	180 Ects
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6 (gjashtë)
16	Aktivizimi i programit të studimit	2005-2006
17	Numri i studentëve	299 studentë*

**Numri i studentëve përfshin tre vitet akademike 2016-2019 që ndjekin aktualisht këtë program studimi. Në këtë numër janë përfshirë studentët të cilët janë rregjistruar për herë të parë në vitin e parë (145 studentë) dhe studentët e transferuar (154 studentë). Totali është 299 studentë.*

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Shkolla e lartë jo Publike, Albanian University, ka nisur aktivitetin akademik në vitin 2004. Programi Bachelor Finance-Banke, është licencuar me Urdhërin nr. 8981, datë 27.12.2005. Ky program është akredituar për herë të parë me Urdhërin nr. 541, datë 01.12.2010, të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Gjatë vitit akademik 2016-2017, ky program i nënshtrohet një procesi riakreditimi. Në periudhën 2006-2009 programi ka qenë implementuar nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara; në periudhën 2010-2014 nga Fakulteti i Ekonomisë dhe në periudhën 2015 e në vazhdim nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Këto ndryshime janë diktuar nga numri i studentëve të rregjistruar, dhe në respekt të kërkesave të MAS lidhur me funksionimin institucional të Fakulteteve dhe të Departamenteve.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ofron programe studimi të ciklit të parë Bachelor dhe të ciklit të dytë Master.

Raporti i vlerësimi nga ekspertët e jashtëm, shqyrton ecurinë e programit të studimit Bachelor në “Financë-Bankë”, që i nënshtrohet procesit të akreditimit periodik. Procesit të vlerësimit të jashtëm është fokusuar në:

- programin e studimit,
- misionin e programit,
- plotësimin e detyrave të lëna nga Bordi i Akreditimit me Vendimin numër 85 të datës 21. 09. 2017,
- kurrikulën,
- stafin akademik, të brëndshëm dhe me kontratë,
- procesin e formimit profesional të studentëve,
- kërkimin shkencor,
- funksionimin e infrastrukturave,
- bashkëpunimin me partnerët kombëtare dhe ndërkombëtare,

Raporti përshkruan analizën e situatës, treguesit e matshëm, si dhe shkallën e përmbushjes së standarteve sipas rubrikave të Udhëzuesit të ASCAL-it. Për secilën rubrikë, ekspertët japin përfundimet dhe rekomandimet respektive.

Raporti i vlerësimit është hartuar nga grupi i eksperteve të jashtëm të vlerësimit i cili përbëhet nga: Profesor, Dr. Sherif BUNDO dhe Dr. Dritan FINO. Grupi i Ekspertëve përdori dokumentacionin që ka vënë në dispozicion Agjensia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të lartë (ASCAL), në faqen e saj zyrtare, në dokumentacionin shtesë, të kërkuar në institucion, të administruar zyrtarisht, si dhe në opinionet e shprehura nga takimet me përfaqësues të Universitetit, Fakultetit, departamentit, studenteve, dhe strukturave të tjera, gjatë vizitës në institucion, në datat 11 dhe 12 qershor 2019.

Në përbërje të grupit të vlerësuesve të jashtëm, një nga anëtarët ka qenë edhe në grupin e vlerësuesve të jashtëm, të procesit të akreditimit të vitit 2017, mbi bazën e të cilit doli Vendimi i Bordit numër 85, datë 21 shtator 2019, ndaj në disa rubrika përgjigjet dhe shpjegimet e GVJ mund të jenë të njëjta, nëse në institucion nuk ka ndryshime të qënësishme apo thelbësore.

Menaxhere teknike e ndjekjes së këtij programi, është Specialstja e ASCAL, Znj Suela Kromidha

Më datë 25 Korrik 2019 nëpërmjet sistemit AMS por edhe me shkresë zyrtare është dërguar në Institucion, Drfat RVJ për këtë program studimi. Më datë 30 Korrik 2019, Institucioni kthen përgjigje mbi këtë Draft duke paraqitur disa komente për përmbajtje të tij. GVJ i pa me kujdes këto komentë duke marrë parasysh vetëm tre prej tyre. Përgjigja e GVJ mbi komentet për këtë Draft është si më poshtë:

Lidhur me komentet që ka përcjellë Institucioni, Grupi i ekspertëve të Jashtëm ka këto qëndrime:

1. Në raportin e GVJ thuhet: “Megjithë që nuk është konsideruar si detyrë e vënë nga Bordi i Akreditimit, Departamenti që mbulon programin e studimit Bachelor në Financë Bankë, ka startuar konfigurimin dhe

funksionimin sipas grupeve të lëndëve, por ky organizim është embrional, pedagogët nuk dinë mirë se cilave grup lëndësh ju përkasin dhe nuk ka funksionim të tyre.” fq.4

Institucioni përgjigjet: Grup lëndët janë funksionale. Veprimtaritë e zhvilluara brenda grup-lëndëve organizohen nga koordinatori i secilës, i cili raporton te Përgjegjësi i Departamentit [Evidencë 1.2, Neni 11]. Disa nga detyrat që realizohen nga grup lëndët janë: rishikimi i kurrikulave dhe syllabuseve; hartimi i kurrikulave të reja; hartimi i pyetjeve të formimit për lëndët e grupit përkatës; orientimi i studentëve mbi temat e diplomave të ofruara nga grupi përkatës etj. Departamenti rishikoi së fundmi kurrikulën e programit “Master i Shkencave në Menaxhim Bankar” dhe në grupin e punës përfshiu edhe koordinatorin e grup-lëndëve bazë Dr. Genti Çela dhe koordinatorin e grup-lëndëve të ekonomiksit Dr. Romina Radonshiqi. [Evidencë Nr. 1]

Përgjigja e GVJ: Në kontaktet me pedagogët dhe stafin akademik, pjestarët e stafit nuk dinin se kujt grupi lëndësh ju përkasin dhe se cilët pedagogë ishin përgjegjësit e grup lëndëve. Për këtë pikë, **GVJ nuk bën ndryshime në raport.**

2. Në raport shkruhet: “Sipas tabelës Nr 1 të paraqitur në DVV, Evidenca 5- Tabelat e RVB për vitin akademik 2017-2018, numri i personelit akademik në Departamentin e Shkencave Ekonomike është dhënë 23 PAE dhe 22 PAK. Ndërsa në tabelën e detajuar për këtë departament, tabela 3, numri i stafit akademik është paraqitur 28 PAE dhe 23 PAK. GVJ I është përmbajtur tabelës së detajuar duke e menduar lapsus të dhënat në tabelën nr 1.” fq. 10

Institucioni komenton Përgjigje: Në tabelën nr.1 pedagogët janë numëruar vetëm një herë, jo në çdo departament ku ata janë të angazhuar, për të shmangur përsëritjet dhe për të nxjerë shifrën totale. Në tabelën 3 listohen të gjithë pedagogët e angazhuar në departament. Diferenca e shifrave I përket pedagogëve që janë pjesë e departamenteve të tjera të Fakultetit, jo të departamentit të Shkencave Ekonomike. Ata janë: Dr. Besjana Tosuni, Dr. Lekë Pepkolaj, Dr. Miranda Harizaj dhe Msc. Besmir Kanushi, të cilët i përkasin Departamentit të Inxhinierive dhe Dr. Sonila Dau e cila i përket Departamentit të Arkitekturës.

Përgjigja e GVJ: GVJ e merr në konsideratë dhe bën ndryshim në raport

3. Në raport GVJ shkruan: “Në listat e personelit akademik të përmendura në raportin e vetvlerësimit, konstatohet se jo të gjithë pedagogët e listuar kanë qënë realisht të angazhuar në mësimdhënie. Ndërkaq, ka një numër të konsiderueshëm pedagogësh që rezultojnë titullarë lëndësh në lëndë që nuk japin mësim. Një situatë e tillë është më e theksuar për pedagogët me tituj dhe grada.” fq.11

Institucioni Përgjigjet: Në raport listohen jo vetëm pedagogët e angazhuar në mësimdhënie për këtë program, por gjithë pedagogët e Departamentit. Pedagogët e tjerë të Departamentit mbështesin studentët me orientime për diplomat, praktikant dhe aktivitete të tjera që organizon departamenti. Titullarët e lëndëve janë zgjedhur referuar Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, Neni 59, pika 3 dhe mundësive të Departamentit duke konsideruar dhe burimet e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike si dhe gjithë grupit të pedagogëve që aderojnë në Albanian University.

Përgjigja e GVJ: Përgjigja dhe shpjegimi i institucionit nuk ka lidhje me çfarë shkruhet në raport. Për këtë pikë, **GVJ nuk bën ndryshime në raport.**

4. Në raport GVJ shkruan: “Në praktikën e rekrutimit, Grupi i Ekspertëve të Jashtëm, konstaton se ka një farë formalizmi për mënyrën se si funksionojnë strukturat e rekrutimit dhe të emërimit të personelit akademik. Kërkesat dhe kriteret për rekrutim hartohen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani. Dekani kryeson komisionin e shqyrtimit të kandidaturave dhe po Dekani bën përzgjedhjen dhe emërimin. Kjo praktikë për mënyrën se si është organizuar dhe se si shfaqet, duket formale dhe paragjyquese.” fq. 12 “Grupi i Ekspertëve të jashtëm vlerëson se pothuaj gjithë praktika e rekrutimit është e përqëndruar në kompetencat e Dekanit, i

cili bën edhe kryesimin e komisionit të vlerësimit të kandidatëve dhe bën njëherësh edhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues, bën edhe emërimin. Këtu ka një non sens.” fq. 13

Institucioni Përgjigjet: Albanian University ka përcaktuar në aktet normative të tij të brendshme, këtë procedurë duke u përpjekur të respektojë nevojat e Njësisë Bazë (Departamenteve) por njëkohësisht duke krijuar një proces konkurrimi sa më transparent dhe të vlerësuar nga përfaqësues me eksperiencë të strukturave kyçe në AU, bazuar edhe në nenin 3 dhe 64 të Ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në të gjithë praktikën e rekrutimit të personelit akademik, roli i Dekanit si përfaqësues ligjor i Fakultetit, por gjithashtu i Dekanatis dhe i Asamblesë së përgjithshme të personelit akademik të Fakultetit, ashtu sikurse Rektori në nivel institucional, është përgjegjës dhe ka për detyrë të nënshkruajë dhe ndjekë veprimet procedurale akademike të Fakultetit përkatës dhe për këtë arsye ai paraqitet kryesisht nëpër akte shkresore që dalin nga Fakulteti. Por kjo nuk nënkupton se ai ka një vendimmarrje absolute, pasi vendimmarrja kryesore në rastin konkret, të përzgjedhjes së kandidatëve fitues në procesin e rekrutimit të stafit akademik e ka komisioni i vlerësimit, në të cilin Dekani është kryetar për efekt përfaqësimi të asaj strukture, por me të drejtë vote si anëtarët e tjerë. Ky Komision vendos me shumicë të cilësuar votash dhe ka detyrimin të respektojë kriteret e vendosura në rregullore dhe ato të vendosura bazuar në nevojat e paraqitura nga Departamenti.

Përgjigja e GVJ: Në përgjigjen e institucionit tentohet ti anashkalohej praktikës që aplikohet në institucion. GVJ ngre problemin e rritjes së rolit të departamentit në përzgjedhjen e stafit, pasi kemi të bëjmë me institucion të arsimit të lartë dhe jo me administratë publike, megjithë që edhe në këtë të fundit, ngrihen komisioni ad-hoc me kompetenca dhetribute profesionale. Për këtë pikë, **GVJ nuk bën ndryshime në raport.**

5. Në raportin e GVJ shkruhet: “Konstatohet se në disa raste, institucioni, ka punësuar në këtë Departament, personel efektiv, me kohë të plotë, punonjës me rezultate mesatare, ose edhe nën mesataren, në shkollimin e tyre. Një gjë e tillë nuk përmbush kërkesat për rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Për më tepër, në ndonjë rast, pedagogët janë angazhuar në mësimdhënie në lëndë apo fusha që nuk përputhen me diplomën e tyre, apo me profilin që kanë studiuar. Rezulton se në Albanian University, ka punonjës që janë të punësuar me kohë të plotë, edhe si pedagogë edhe si punonjës të profilit administrativ. Me shpjegimet që u dhanë për Ekspertët e jashtëm nga punonjësit e burimeve njerëzore, rezulton se i njëjti punonjës posedon njëherësh disa vende pune me kohë të plotë. Dy punësimi lejohet për pedagogët por jo brenda të njëjtit institucion dhe jo të dyja punët me kohë të plotë.” fq. 12

Institucioni Përgjigjet: Konstatimi se i njëjti personel posedon në të njëjtën kohë disa vende pune me kohë të plotë është mendim subjektiv për atë kohë sa nuk është i provueshëm. Kjo, pasi personeli i cili cilësohet si i dypunësuar, në fakt është i punësuar me një kontratë pune të vetme, por me funksione të ndryshme. Ai personel është i deklaruar vetëm njëherë në organet tatimore dhe i paguhen sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për një kontratë pune me kohë të plotë. Këto funksione ushtrohen nga punëmarrësit brenda kohës ditore të punës, e cila nuk kalon në asnjë rast kohëzgjatjen prej 8 orësh. Kjo kohëzgjatje rregullohet sipas kontratës së punës në përputhje me nenin 21(2) dhe 78 të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë. Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64(2) parashikon se: “Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në një institucion të arsimit të lartë nuk mund të punësohet si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjetër të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit. Ai mund të angazhohet me kohë të pjesshme vetëm në një institucion tjetër të arsimit të lartë, me miratimin e drejtuesit të njësisë bazë dhe të rektorit, si dhe në marrëveshje mes institucioneve. Pjesëmarrja e personelit akademik në projekte, konsulenca, botime dhe shërbime që realizohen në institucionin e arsimit të lartë, ku ai është i punësuar me kohë të plotë, nuk konsiderohet si dypunësim brenda institucionit.” Ndalimi ligjor i referuar nga grupi i kontrollit, nuk provohet aspak në rastin e personelit të Albanian University. Kjo, pasi neni 64(2) i Ligjit 80/2015 ndalon personelin akademik të punësohet në dy punë me kohë të plotë në dy institucione të ndryshme të Arsimit të Lartë, dhe jo të kryejë një punë me funksione të ndryshme brenda të njëjtit institucion. Funksionet janë pjesë e përshkrimit të punës në kontratat e punës dhe janë pranuar prej personelit akademik me vullnet të lirë. Angazhimi administrativ i personelit nuk e pengon atë të kryejë funksionet akademike sipas kërkesave normative të miratuara nga Departamentet. Zyra e burimeve njerëzore kontrollon

zyrtarisht përmbushjen e kritereve të dypunësimit të Personelit Akademik Efektiv dhe Departamenti harton e kërkon lejet për mësimdhënie për pedagogët efektivë dhe me kontratë. Cilësia e stafit dhe përputhshmëria e formimit me angazhimin gjendet ne evidencën H.5.

Përgjigja e GVJ: Në përgjigjen e vet, institucioni e anashkalon thelbin e problemet. Për këtë pikë, **GVJ nuk bën ndryshime në raport.**

6. Në raport GVJ shkruan: “Gjatë vizitës në institucion, grupi i ekspertëve të jashtëm, konstaton se kriteret nuk janë të plota. Ato duhet të përfshijnë edhe mesataren e notës, të kandidatit, në studimet e nivelit bachelor dhe në studimet e nivelit Master. Gjithashtu në kritere duhet të përfshihet si kërkesë, edhe përvoja në mësimdhënie në fushën përkatëse.” fq. 12

Institucioni Përgjigjet: Kriteri e rekrutimit të Departamentit të Shkencave Ekonomike përfshijnë: notën mesatare të studimeve Master mni 8 (tetë); minimumi 3 (tre) vite eksperiencë pune dhe njohuri në lëndët që duan të angazhohen. [Evidencë 3.1]

Përgjigja e GVJ: Në rekrutim institucioni nuk merr parasysh shkollimin në nivelin Bachelor, profilin dhe mesataren në këtë nivel studimi të kandidatëve që rekruton për staf akademik. Duke qënë se në diplomat Master mund të hyjnë edhe kandidatë me diploma Bachelor nga fusha të tjera, GVJ gjykon që duhet të ruhet një koherencë në linjën e formimit akademik të kandidatëve, sikurse vepohet përgjithësisht në shkollat e tjera. Për këtë pikë, **GVJ nuk bën ndryshime në raport.**

7. Në raport GVJ shkruan: “Praktikat e studentëve nuk ndiqen nga stafi akademik në ndërmarrjet apo institucionet në të cilat ata kryejnë praktikat mësimore.” fq. 19

Institucioni Përgjigjet: Departamenti cakton për çdo student një udhëheqës praktike i cili kontrollon, informon mbi mbarëvajtjen e praktikës si dhe jep vlerësim në fund të këtij procesi. Studenti instruktoret si duhet të veprojnë në praktikë dhe meqë praktika zhvillohet në fund të studimeve Bachelor studenti është i gatshëm të fillojë marrëdhënie pune pa mentorim.

Përgjigja e GVJ: **GVJ e merr në konsideratë përgjigjen e AU dhe bën ndryshime në raport, duke e riformuluar në këtë mënyrë:** “Nga kontaktet me studentët doli se praktikat e tyre nuk ndiqen nga stafi akademik në ndërmarrjet apo institucionet në të cilat ata kryejnë praktikat mësimore.” fq. 19

8. Në raport, GVJ shkruan: “Në dy vitet e fundit akademike në hapësirën 2017-2019, janë pyetur rreth 37% e studentëve të programit të studimit Bachelor në Financë/Bankë. Të dhënat e anketave janë përpunuar nga ZBSC dhe rezultatet ju janë përcjellë organeve më të larta drejtuese. Nuk rezulton që stafi akademik efektiv dhe me kontratë, të njohin periodikisht opinionin e shprehur nga studentët në anketimet e bëra me ta. Po kështu studentët u shprehën se jo gjithnjë ata janë intervistuar dhe kanë plotësuar pyetësorë lidhur me vlerësimin e cilësisë dhe me mbarëvajtjen e programit të studimeve Bachelor në Financë-Bankë.” fq. 21

Institucioni Përgjigjet: Anketimi i studentëve aplikohet prej disa vitesh, në fund të çdo semestri mësimor. Pjesëmarrja e studentëve në to është me dëshirë dhe jo me detyrim. Përvec anketimit, NjSBC organizon fokus-grupet ku ftohen disa prej studentëve, në mënyrë rastësore për të shprehur në mënyrë të detajuar shqetësimet lidhur me pedagogët, lëndët, procesin mësimor apo dhe stafin mbështetës e infrastrukturën mësimore. Pedagogët e dinë që në procesin e nënshkrimit të kontratës që një pjesë e vlerësimit të tyre është opinionin i shprehur në anketat e studentëve, në focus grupe, etj. Pedagogëve ju komunikohet individualisht rezultati (takim me Drejtuesin e Departamentit) dhe në mbledhjen e Departamentit të fundit të semestrit diskutohen çështje dhe problematika që kanë rezultuar nga përpunimi i pyetësorëve.

Përgjigja e GVJ: GVJ nuk ka dhe nuk ka shprehur opinione lidhur me kampionin e studentëve të intervistuar. Në takimin me stafin akademik, me përjashtim të drejtuesve të departamenteve, pedagogët e tjerë nuk kishin informacion lidhur me opinionet e shprehura prej studentëve. Në se ky opinion nuk shkon te stafi, atëherë impakti i reflektimit ndaj tyre nuk do të jetë i plotë dhe po kështu edhe pritshmëritë. Për këtë pikë, **GVJ nuk bën ndryshime në raport.**

9. Në raport, GVJ, shkruan: “Vlerësimi i cilësisë së programit, nëpërmjet cilësisë së të diplomuarëve të punësuar, prej partnerëve dhe prej tregut, nuk është një praktikë e rregullt pune.” fq. 24

Institucioni Përgjigjet: Departamenti realizon studimin e tregut të punës një herë në tre vite. [Evidencë 1.4] Në panairin e karrierës që organizohet çdo vit, institucionet e shumta që marrin pjesë janë një matës i mirë i vlerësimit të cilësisë së programit nga tregu i punës. Institucioni nëpërmjet angazhimit në projektin GRADUA <https://vvvvvv.graduproject.com/> do të ketë shumë shpejtë të dhëna statistikore për pozicionimin e të diplomuarëve në tregun e punës dhe interesin e kompanive për të diplomuarit e AU. Numri i qëndrueshëm i studentëve në vitet e fundit si dhe punësimi i të diplomuarëve është një tregues pozitiv i kërkesave të tregut të punës.

Përgjigja e GVJ: Vlerësimi i cilësisë së të diplomuarëve nëpërmjet ndjekjes së ecurisë dhe karrierës së tyre dhe kontakteve me partnerët nuk ishte dhe nuk është praktikë pune. Studimet e tregut dhe pjesëmarrjet në panairin e karrierës, apo dinamika e të punësuarëve janë tregues të tjerë. Për këtë pikë, **GVJ nuk bën ndryshime në raport.**

10. Në raport GVJ shkruan: “Sekretaria mësimore nuk e kishte praktikë pune që të evidentonte në regjistrin vlerësimet negative të studentëve” fq. 32

Institucioni përgjigjet: Sekretaria mësimore evidenton vlerësimet negative dhe penalitetet e frekuentimit nëpërmjet procesverbaleve të cilët kanë të dhëna të detajuara dhe lehtësojnë gjurmimin e studentëve në sezone dhe vite të ndryshme. [Evidencë 8.1] Regjistri pasqyron rezultatet e lëndëve të shlyera/kaluara; për çdo rast tjetër sekretaria i referohet procesverbaleve të notave.

Përgjigja e GVJ: GVJ e merr në konsideratë përgjigjen e AU dhe bën ndryshime në raport, duke e riformuluar në këtë mënyrë: “Sekretaria mësimore nuk e kishte praktikë pune që të evidentonte në regjistrin vlerësimet negative të studentëve, por ato gjurmohen në mënyrë ekstra me dokumenta jashtë regjistrin”

Raporti përmbillet me një analizë përmbledhëse të anëve të forta dhe të dobëta lidhur me programin e studimit: Bachelor në Financë-Bankë.

Përbërja e GVJ:

1. Profesor, Dr. Sherif BUNDO
2. Dr. Dritan FINO

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Të sigurohet stabiliteti i stafit të kualifikuar akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme me qëllim qëndrueshmërinë e formimit dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies,
- b) Të rekrutohet staf i ri akademik, me qëllim uljen e ngarkesës mësimore të stafit akademik aktualisht të angazhuar në këtë program studimi,
- c) Të vlerësohet cilësia e pedagogëve me mesatare, sipas kriterëve të kërkuara të rekrutimit, duke i dhënë rëndësi mesatares së formimit si dhe përputhshmërisë së fushës së tyre akademike me lëndët që mbulojnë në kuadër të programit të studimit,
- d) të shtohet numri i botimeve në gjuhën shqipe dhe atyre të viteve të fundit në dispozicion të studentëve në bibliotekën e fakultetit,
- e) të ngrihet sekretaria online dhe tu ofrohen shërbime online studentëve,

f) stafi akademik në përbërje të departamentit përgjegjës për këtë program studimi, rekomandohet të angazhohet sipas lëndëve të ngjashme, sikurse në departamente të tjera të këtij institucioni dhe të angazhohet më shumë në veprimtari kërkimore dhe shkencore.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

a) Lidhur me rekomandimin për stabilitetin e stafit të kualifikuar akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme me qëllim qëndrueshmërinë e formimit dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, në institucion janë bërë hapa të mirë progresi. Në institucion nuk janë përsëritur ndryshime masive dhe më shumë se 80 % e stafit akademik të brëndshëm dhe të jashtëm kanë angazhim disa vjeçar. Në fakultetin e shkencave të aplikuara dhe ekonomike, janë angazhuar katër pedagogë të rinj, të cilët janë të angazhuar me mësimdhënie edhe në Departamentin e shkencave ekonomike që mbulon programin e studimeve Bachelor në Financëbankë. **Rekomandimi është plotësuar**

b) Lidhur me rekrutimin e stafit të ri akademik, GVJ konstaton se janë rekrutuar katër pedagogë të rinj, me kritere të mirë përcaktuara, dhe niveli akademik i stafit të rekrutuar është cilësor. Nga katër pedagogë të rekrutuar, tre janë me grada shkencore dhe tituj akademikë. Në vitet akademike 2017-2018 dhe 2018-2019, janë rekrutuar gjithsej 7 pedagogë. (Evidencat H.3.2 dhe H.4) **Rekomandimi është plotësuar**


c) Pedagogët e rekrutuar kanë mesatare relativisht të lartë. Ata janë përzgjedhur në përputhje me fushat e kërkuara dhe japin mësim në lëndët e formimit të tyre akademik dhe profesional. **Rekomandimi është plotësuar**

d) Lidhur me rekomandimin për pasurimin e fondit të librave të bibliotekës së institucionit, konstatohet se është shtuar numri i titujve, ka tituj të botimeve të viteve të fundit, të autorëve të njohur vëndas dhe të huaj. GVJ konstaton se fondi i librave të bibliotekës përdoret dhe shfrytëzohet pak nga studentët dhe librat janë të kufizuar vetëm për përdorim brënda institucionit. Në bibliotekë ka 331 tituj libra nga fusha e ekonomisë. **Rekomandimi është plotësuar kryesisht**

e) Në fakultet është ngritur dhe funksionon sekretaria online, por shërbimet që u ofrohen studentëve nga ky lloj shërbime janë shumë të limituara dhe ajo përdoret më shumë për komunikime të karakterit administrativ se sa për komunikime të procesit pedagogjik, të mësimdhënies dhe të informacionit. **Rekomandimi është plotësuar kryesisht**

f) Stafit akademik është i angazhuar sipas lëndëve që kanë ngjashmëri me fushat e tyre të formimit akademik. Nuk ka pedagogë të angazhuar në më shumë se katër lëndë. Ndërkohë, duhet nënvizuar se formalisht, në syllabusat e lëndëve ka disa emra që figurojnë si titullarë lëndësh edhe pse faktikisht ata nuk janë të angazhuar në mësimdhënie për disa nga lëndët që ata figurojnë si tutullarë. **Rekomandimi është plotësuar kryesisht**

Megjithë që nuk është konsideruar si detyrë e vënë nga Bordi i Akreditimit, Departamenti që mbulon programin e studimit Bachelor në Financë Bankë, ka startuar konfigurimin dhe funksionimin sipas grupeve të lëndëve, por ky organizim është embrional, pedagogët nuk dinë mirë se cilave grup lëndësh ju përkasin dhe nuk ka funksionim të tyre.



ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

GVJ ka shqyrtuar një sërë dokumentash që ka paraqitur Institucioni në Dosjen e vetvlerësimit për këtë program studimi, Si Rregulloren e Institucionit, Rregulloren e Departamentit; Rregulloren e Programit të studimit etj. Programi ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Departamenti i Shkencave Ekonomike, në bashkëpunim edhe me Departamente të tjera të AU.

Mbështetur në Rregulloren e programit të studimit, Neni 4, Objektivat e përgjithshme të këtij programi janë:

- Përputhshmëria me Misionin dhe Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit
- Hartimi në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik
- Formimi i studentëve, përfshirja e dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale në përfundim të studimeve

Si Objektiva specifike të programit përmendim: synimin për ti ofruar studentëve njohuri të përgjithshme të mbështetura në lëndë të formimit bazë duke përgatitur ekonomistë finance të profilit bankar me njohuri bashkëkohore, të aftë të punojnë në institucione financiare.

Qëllimi i kurikulës është tu ofrojë studentëve njohuri të cilat të jenë të nevojshme edhe për tu ndjekur në ciklet e tjera të studimit dhe në të njëjtën kohë tu përgjigjet kërkesave me të cilat të përballen studentët gjatë realizimit të tyre profesional.

Mbështetur në Raportine vlerësimit të brendshëm, GVJ konstaton se *Objektivat e Departamentit përgjegjës për këtë program janë:*

- *Rishikimi i teksteve bazë dhe përditësimi i literaturës plotësuese*
- *Rishikimi i syllabuseve të lëndëve (deri 20% ndryshim) dhe i ngarkesës mësimore*
- *Vëzhgimi i cilësisë në procesin e mësimdhënies*
- *Krijimi i lidhjeve dhe marrëveshjeve me universitete kombëtare dhe ndërkombëtare*
- *etj*

Programi i studimit Bsc në Financë-Bankë, po vlerësohet për herë të tretë nga Ekspertë të jashtëm.


Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	



<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përmbushje të misionit dhe qëllimeve të Albanian University, konform strategjisë së zhvillimit afatgjatë të institucionit dhe në përputhje me kërkesat e tregut.</p> <p>Ky program synon përgatitjen e studentëve të financës dhe bankës, niveli bachelor, me njohuri bazë në këto fusha. Programi është në harmoni me zhvillimet e tregut dhe të IAL të tjera të ngjashme, i ndërtuar me synimin që tju japë studentëve njohuritë bazë teorike dhe praktike, në këto fusha. Objektivi është që studentët të aftësohen dhe të fitojnë kopetencat për të punuar në sektorë të ndryshëm të financës, bankës dhe me opsion edhe për shërbimet financiare të bizneseve.</p> <p>Institucioni nuk ka një studim të freskët tregu lidhur me kërkesën dhe ofertën për këtë program. Programi i studimit merr në konsideratë kërkesat e kohës të bizneseve, zhvillimet në tregun financiar dhe bankar si dhe zhvillimet në fushën e teknologjisë.</p> <p>Ecuria e studentëve të këtij programi shihet nga institucioni më tepër si fazë përgatitore për nivelin e dytë të studimeve se sa si punësim në ndërmarrje dhe institucione të ndryshme. Një studim i kryer nga Departamenti i shkencave ekonomike ofron të dhëna pjesore për punësimin e studentëve mbas diplomimit, në nivelin Bachelor, si dhe informacione mbi opinionin e punëdhënësve për këto diploma.</p> <p>Programi i studimit dhe syllabusat e lëndëve janë pasuruar në mënyrë të vijueshme. Nga vëzhgimi i progresit për një periudhë disa vjeçare, rezulton se programet e studimeve të diplomës Bachelor në Financë-Bankë, janë përmirësuar dhe përshtatur, në përputhje me tendencat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe me zhvillimet e reja në treg.</p>
---	--

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi Bachelor në Financë-Bankë, për Albanian University, është i harmonizuar me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Ky program është i harmonizuar edhe me nivelet e tjera të studimeve çka ju jep mundësinë studentëve të vijojnë studimet më tej, ose të përzgjedhin dhe diversifikojnë formimin e tyre. Po kështu, zhvillimi i Departamentit të shkencave ekonomike dhe perspektiva e tij, bazohet edhe në perspektivat për zgjerimin dhe ecurinë e këtij programi.</p> <p>Programi i studimit parashikon lëndë të formimit të përgjithshëm bazë, të tilla si: matematika, statistika, njohuri në informatikë, si dhe formimin me orientim të përgjithshëm ekonomik, si makroekonomi, mikroekonomi, bazat e menaxhimit, bazat e financës, etj.</p> <p>Lëndët e formimit bazë janë të parashikuara në programin e studimit në vitet e para të studimit të studentëve dhe ju jep atyre mundësinë e përzgjedhjes dhe të penetrimit në lëndë të tjera më të avancuara progresivisht me kalimin e viteve</p>



	tëstudimit. Programi synon formimin në fusha specifike të lidhura me financën, me kontabilitetin dhe me bankën. Në program jepet mundësia e fleksibilitetit për aftësimin në shërbime të tjera financiare. Në program, ka lëndë të formimit profesional, si Bazat e Financës, Hyrje në kontabilitet, Kontabilitet Financiar, Tregjet dhe Institucionet financiare, Drejtim Financiar, Investime, Kontabilitet Kosto/Drejtimi, Analizë Financiare, etj, ku krahas materialeve bazë teorike, sipas rastit zhvillohen edhe punime kursi, raste studimi, ese, analiza situatash të ndryshme, etj.
--	---

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi i studimeve synon të orientojë formimin profesional të studentëve në përputhje me kërkesat dhe standardet e tregut të punës, i cili në vitet e fundit ka pësuar ndryshime të vullshme, sasiore dhe cilësore.</p> <p>Objektiv i programit është edhe aftësimi i studentëve për të ndjekur studimet në nivelet Master Profesional, apo shkencor, në të njëjtin universitet, apo edhe në universitete të tjera. Në takimet me studentët u evidentua fort fakti që ata dëshirojnë të diversifikojnë formimin e tyre akademik dhe profesional.</p> <p>Institucioni nuk ka të dhëna lidhur me ecurinë e numrit të të regjistruarëve në këtë program studimi, në harmoni me kërkesat e tregut dhe me zhvillimet e tregut në institucionet e tjera të ngjashme. Parashikimi dhe prognoza e të regjistruarëve është kryesisht e bazuar në kapacitetet e institucionit më tepër se sa në kërkesat punëdhënësve apo në parashikimin e pritshëm.</p> <p>Institucioni ka kryer para disa vitesh njëstudim për tregun e punës, i cili nuk evidenton në mënyrë të plotë, mundësitë e punësimit të studentëve, në tregun vendas, kërkesat potenciale të punëdhënësve, dhe mbi këtë bazë parashikim më të drejtë të numrit të studentëve në vitet që vijnë për këtë program.</p> <p>Ndërkohë, departamenti ka realizuar gjatë periudhës korrik-gusht 2016, një studim për tregun e punës i cili ofron gjetjet e dy studimeve të pavarura për zotërimin e njëje informacioni të vlefshëm lidhur me (1) mundësitë e punësimit të të diplomuarëve në tregun e punës dhe (2)“ Perceptimin e punëdhënësve për punësimin e të diplomuarve”.</p>
---	--

Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Në realizimin e misionëve të tij, universiteti vepron në respekt të së drejtave themelore të njeriut të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kartat, Deklaratën e Bolonjës, Ligjin Për Arsimin e Lartë në RSH dhe Konventat evropiane dhe ndërkombëtare.</p> <ul style="list-style-type: none"> Universiteti është i pavarur nga cdo lloj orientimi ideologjik, politik apo fetar;
--	--

- vepron në përputhje dhe në respekt të parimeve kushtetuese dhe të dispozitave ligjore në fuqi;
- garanton lirinë e studimit, të mësimdhënies dhe të kërkimit të lirë shkencor.

Programi i studimit “Finance-Bankë” mbështetet në traditat më të mira në këtë fushë në RSH. Programi respekton lirinë akademike, inkurajon iniciativën, kërkimin shkencor, bashkëpunimin me institucione të tjera të AL, me partnerë vëndas, lokalë dhe kombëtarë, bashkëpunimin me institucione të pushtetit vendor dhe qëndror, me ndërmarrjet dhe bizneset, me botën e punës dhe të profesionave.

Konkluzione të GVJ:

- Programi Bachelor në “Financë-Bankë” është ndërtuar në përputhje me misionin e institucionit dhe qëllimet e tij. Programi vijon të përmirësohet në përputhje me ndryshimet dhe dinamikën e fushës.
- Programi i studimit mbështet strategjinë për zhvillim të institucionit; ofron formim të mirë me njohuritë bazë dhe speciale në fushën e financës dhe të bankës.
- Programi bazohet dhe respekton traditën në fushën e arsimit të lartë ekonomik e financiar, arritjet dhe kërkesat e institucioneve financiare dhe bankare, si dhe bashkëpunon me partnerët e tjerë lokalë dhe kombëtarë në këto fusha si dhe në fushat e tjera të përafërta.
- Programi i studimit është ndërtuar më tepër si faza paraprake e formimit të studentëve të cilët duhet të vijnë në studimet edhe në nivele të tjera, më tepër se sa në përmbushje të kërkesave të tregut të punës.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Departamenti i shkencave ekonomike është pjesë e organigramës së Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Ky Departament mbulon programe Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave.

Programi i studimeve Bachelor në Financë-Bankë, ka qënë ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në vitet 2006-2009, nga Departamenti i Financë-Bankës, në Fakultetin e Ekonomisë për periudhën 2010-2014 dhe nga Departamenti i Shkencave Ekonomike, pjesë e Fakultetit të Shkencave të aplikuara dhe ekonomike në vitet 2015 dhe në vazhdim. Universiteti i justifikon këto ndryshime me luhatjen e numrit të studentëve të rregjistruar në këto programe, si dhe në përmbushje të kërkesave të Minsistrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë.

Piramida drejtuese, mësimore-shkencore dhe administrative e institucionit në të cilin është implementuar ky program:

A. Autoritetet Drejtuese:

- Dekani,
- Përgjegjës të Departamenteve.

B. Njesite baze të punës mësimore shkencore:

- Departamenti i Shkencave Ekonomike,
- Departamenti i Inxhinierive,
- Departamenti i Arkitektures,

C. Njësitë përbërëse të administratës së Fakultetit:

- Kancelari i Fakultetit,
- Asistentet e departamenteve,
- Sekretaria mesimore,
- Biblioteka.

Përshkrim i autoriteteve dhe strukturave drejtuese të Fakultetit:

Sipas gjetjeve të inspektimit dhe të vizitës në institucion, konstatohet se institucioni ka bërë përmirësime strukturore në funksionimin e tij në përshtatje me kërkesat e Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Komplementimi i akteve të tjera nënligjore dhe normative që pritet të dalin nga MAS do të shërbejnë për të realizuar riorganizimin e plotë të institucionit dhe të strukturave të tjera, përfshirë edhe ato që lidhen me programin Bachelor në Financë-Bankë. (Organet drejtuese, Përgjegjës Departamenti, si drejtuesi Kryesor i Njësisë bazë dhe Dekani, si Drejtuesi kryesor i Njësisë kryesore, konsiderohen si punonjës dhe drejtues që emërohen nga administratori dhe Bordi Drejtues, dhe jo si të zgjedhur, sic ndodh në IAL publike). Nga aktet kryesore të Institucionit shkëpusim, sa vijon:

Fakulteti është njësi kryesore e Universitetit që organizon dhe drejton mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme në përfundim të së cilave përfitohet diplomë sipas ciklit përkatës. Sipas Statutit të Universitetit, Fakulteti përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë mësimore-shkencore dhe nga administrata. Autoritetet drejtuese janë Dekani, Zëvendës Dekani dhe Përgjegjësit e departamenteve. Organ drejtues është Këshilli i Fakultetit. Aparati administrativ i Fakultetit përbëhet nga Sekretaria mesimore dhe nga personeli ndihmës.

Këshilli i fakultetit është organ drejtues kolegjal vendimmarrës i cili drejtohet nga Dekani. Këshilli i fakultetit përbëhet nga anëtarë të stafit akademik, administrativ dhe studentë. Mandati i Këshillit të Fakultetit është 4 vjeçar. (Aneksi VII)


Dekani është funksionari më i lartë drejtues dhe përfaqësues i Fakultetit. Dekani emërohet dhe shkarkohet nga detyra nga Administratori i Universitetit me propozimin e Senatit akademik për një mandat 4 vjeçar me të drejtë riemërimi. Dekani duhet të ketë të paktën titullin “Profesor i Asociuar” ose gradën shkencore ‘Doktor’ të fituar pranë universiteteve perëndimore. Dekani i Fakultetit drejton, kontrollon, organizon dhe përgjigjet për ecurinë e procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor në Fakultet. Dekani është funksionari llogaridhënes që përfaqëson Fakultetin pranë Senatit Akademik dhe Bordit Administrativ.

Departamenti është njësi bazë mësimore-shkencore në Fakultet. Ai ka për detyrë të nxisë, të bashkërendojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit.

Përgjegjësi i departamentit në Fakultet është funksionari më i lartë drejtues i Njësisë, i cili drejton, organizon, koordinon dhe përgjigjet për punën mësimore dhe kërkimore shkencore në njësinë bazë dhe i raporton Dekanit. Përgjegjësi i Departamentit propozohet nga Senati akademik dhe emërohet nga Administratori me një mandat 4 vjeçar me të drejtë riemërimi.

Të dhëna për ndarjen e personelit në këto njësi bazë, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ:

Personeli Akademik përbëhet nga pedagogët me kontratë me kohë të plotë si dhe personeli akademik i ftuar ku përfshihen profesorët dhe lektorët. Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në kontratën e punës dhe në rregullore.



Koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera:

Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, ashtu sikurse çdo Departament, në fillim të vitit akademik për lëndë/module që janë pjesë e kurrikulës së tij, por jo pjesë e disiplinës, angazhon pedagogë nga Departamentet e tjera brenda Fakultetit apo dhe jashtë tij, brenda Universitetit. Kështu ndodh përshëmbull, për lëndet që i përkasin shkencave juridike, pedagogu kërkohet nga departamenti i cili e ka këtë pedagog në strukturën e tij për të mbuluar këtë ngarkesë, dhe anasjelltas për lëndë të departamenteve të tjera që i përkasin programit të studimit në “Financë-Bankë” Departamenti çon pedagogët e tij për të dhënë mësim.

Tregues të matshëm:

Struktura didaktike (Departamentet) për programin e studimit:

Struktura akademike përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Finance-Bankë” është Departamenti i Shkencave Ekonomike. Struktura të tjera bashkëpunuese mësimore-shkencore janë departamentet e tjera të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamenti i Shkencave Juridike (për lëndën ‘Parimet e së Drejtës’) pjesë e Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA), dhe përbërja e stafit në Departament, janë paraqitur në Anekse tabela 1 dhe 2 për stafin akademik numerik për vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019

Përbërja e stafit të Departamentit për vitet akademike 2017-2018 dhe 2018-2019, e detajuar (Shiko Anekse, tabela 3 dhe tabela 4) paraqitet si më poshtë:

Viti akademik 2017-2018 – 28 PAE dhe 23 PAK

28 PAE - 1 Prof. Dr; 4 Prof. As; 11 Dr; 3 Dr në proces; 8 Msc; 1 Ma

23 PAK – 3 Prof. Dr; 9 Prof. As; 6 Dr; 4 Msc; 1 Ma

Viti akademik 2018-2019 – 22 PAE dhe 22 PAK

22 PAE – 4 Prof As; 8 Dr; 4 Dr në proces; 6 Msc

22 PAK – 3 Prof. Dr; 7 Prof As; 6 Dr; 4 Msc; 2 MA

Nga analiza krahasuese e strukturës së departamentit dhe e përbërjes së tij akademike, GVJ konstaton se ka një përmirësim të dukshëm të nivelit akademik, të numrit të pedagogëve me tituj dhe grada shkencore dhe me eksperiencë mësimdhënëse në këtë Departament.

Departamenti i Shkencave Ekonomike, nga pikpamja e numrit të pedagogëve, e personelit me tituj dhe grada, numrit të studentëve të regjistruar në të gjitha programet (Bachelor dhe Master) dhe eksperiencës së fituar, në opinionin tonë përfaqëson një strukturë të rëndësishme të fakultetit.

3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Dinamika e Personelit akademik në numër, angazhuar në programin “Financë-Bankë” në periudhën 2017-2019, ka qënë si më poshtë:



- Në vitin akademik 2017-2018 janë angazhuar 16 pedagogë efektivë nga të cilët 8 janë me tituj dhe grada shkencore dhe 11 pedagogë me kontratë nga të cilët 7 janë me tituj dhe grada shkencore; (Shiko Anekse, tabela 5)
- Në vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 17 pedagogë efektive nga të cilët 7 janë me tituj dhe grada shkencore dhe 11 pedagogë me kontratë nga të cilët 6 janë me tituj dhe grada shkencore; (Shiko Anekse Tabela 6)

Të dhënat më të detajuara janë paraqitur si më poshtë:

Viti akademik 2017-2018 – 16 PAE dhe 11 PAK

16 PAE – 3 Prof. As; 5 Dr; 4 Dr në process; 4 Msc
11 PAK – 1 Prof Dr; 3 Prof. As; 3 Dr; 3 Msc; 1 MA

Viti akademik 2018-2019 – 17 PAE dhe 11 PAK

17 PAE – 2 Prof As; 5 Dr; 4 Dr në process; 6 Msc
11 PAK – 1 Prof Dr; 3 Prof As; 2 Dr; 4 Dr në process; 1 Ma

Gjatë viteve akademike 2017-2018, dhe 2018-2019 janë regjistruar për herë të parë degën Financë-Bankë (bachelor) pranë këtij Universiteti respektivisht 29, dhe 57, studentë. Ndërkohë që janë pranuar si studentë të transferuar respektivisht edhe 17 studentë në vitin akademik 2017-2018 dhe 11 studentë në vitin akademik 2018-2019. Tre vitet e fundit numri i studentëve të regjistruar nuk ka pësuar ndonjë dinamikë të ndjeshme.

Koment për përbërjen e stafit akademik:

Ekspertët e jashtëm, krahasuan stafin akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme, për vitet akademike 2017-2018 dhe 2018-2019, në nivel Departamenti dhe stafin akademik të angazhuar në programin e studimeve Bachelor në Financë-Bankë dhe konkluduan se:

- Në listat e personelit akademik të përmendura në raportin e vetvlerësimit, konstatohet se jo të gjithë pedagogët e listuar kanë qënë realisht të angazhuar në mësimdhënie.
- Ndërkaq, ka një numër të konsiderueshëm pedagogësh që rezultojnë titullarë lëndësh në lëndë që nuk japin mësim. Një situatë e tillë është më e theksuar për pedagogët me tituj dhe grada.

Koment për ndryshimet e stafit akademik:

Në ndryshimet e stafit akademik me kohë të plotë, sipas strukturës moshore dhe krahasuar me raportin e VJ të vitit akademik 2017, rezulton se ndryshimet më të mëdha të stafit akademik janë ato që kanë të bëjnë me pedagogët e rinj, pa përvojë dhe pa tituj dhe grada shkencore. Në kategorinë 25-35 vjeç, nga 12 pedagogë në këtë kategori në vitin 2017, aktualisht janë vetëm 9. Nuk rezulton ndryshim i ndjeshëm në kategoritë e tjerë, pedagogë me tituj dhe grada shkencore, që të mendohet se nga pedagogë pa tituj janë kaluar në rubrikën pedagogë me gradë shkencore ose më tituj akademikë. Shiko Anekse, tabela 7 dhe Tabela 7/1

Nevojat për personel akademik dhe administrativ

Në fillim të çdo viti, Departamenti i Shkencave Ekonomike i paraqet Këshillit të Fakultetit, kërkesat për vëndet vakante. Ky i fundit, miraton kriteret, procedurat dhe i dërgon këto në trajtën e kërkesave pranë Rektoratit të Universitetit. Rektorati i bën publike në organet e medias dhe në kanalën televiziv të universitetit. Institucioni ka ngritur një komision të posaçëm vlerësimi, në të cilin si rregull bëjnë pjesë, përgjegjësit e njësive bazë, si dhe dy antarë të personelit akademik dhe përfaqësues nga zyra e kurrikulave dhe nga burimet njerëzore.

Në praktikën e rekrutimit, Grupi i Ekspertëve të Jashtëm, konstaton se ka një farë formalizmi për mënyrën se si funksionojnë strukturat e rekrutimit dhe të emërimit të personelit akademik. Kërkesat dhe kriteret për

rekrutim hartohen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani. Dekani kryeson komisionin e shqyrtimit të kandidaturave dhe po Dekani bën përzgjedhjen dhe emërimin. Kjo praktikë për mënyrën se si është organizuar dhe se si shfaqet, duket formale dhe paragjyqese.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat e të punësuarëve

Institucioni ka lidhur kontrata pune, me afat të pacaktuar për çdo anëtar akademik me kohë të plotë. Në kontratë parashikohen, kushtet e punës, zgjatja e kohës së punës, të drejtat dhe detyrimet reciproke të palëve, shpërblimi, ngarkesa në auditor dhe jashtë auditorit, lëndët dhe fushat për të cilat do të angazhohet pedagogu, etj.

Stafi i njej të drejtat e tij, dhe ka firmosur në çdo kontratë punësimi. Konstatohet se paga e caktuar në kontratën e punës, jo në mënyrën klasike si pagë bazë dhe shtesa për kualifikime që i përshtatet natyrës së punës dhe profilit të veçantë akademik të pedagogut por si pagë orare, që është në një farë mënyre page me normë. Ngarkesa në auditor dhe norma e punës janë dy gjëra të ndryshme. Gjykojmë se kjo formë pagese dhe shpërblimi fiksuar në kontratën e punës nuk është ndërtuar në raport me tregun dhe me kërkesat intelektuale që kërkohen nga pedagogët dhe gjykojmë që ky nivel page, nuk motivon dhe nuk nxit prurje cilësore të stafit akademik efektiv (kërkesë kjo e strategjisë dhe e standardeve të cilësisë së mësimdhënies). Pagën për çdo orë mësimore të realizuar që në kontratat e mëpërshme e ka pasur si shtesë mbi pagë, në vitet e fundit e ka kaluar si formën kryesore të shpërblimit.

Konstatohet se në disa raste, institucioni, ka punësuar në këtë Departament, personel efektiv, me kohë të plotë, punonjës me rezultate mesatare, ose edhe nën mesataren, në shkollimin e tyre. Një gjë e tillë nuk përmbush kërkesat për rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Për më tepër, në ndonjë rast, pedagogët janë angazhuar në mësimdhënie në lëndë apo fusha që nuk përputhen me diplomën e tyre, apo me profilin që kanë studiuar. Rezulton se në Albanian University, ka punonjës që janë të punësuar me kohë të plotë, edhe si pedagogë edhe si punonjës të profilit administrativ. Me shpjegimet që u dhanë për Ekspertët e jashtëm nga punonjësit e burimeve njerëzore, rezulton se i njëjti punonjës posedon njëherësh disa vënde pune me kohë të plotë. Dy punësimi lejohet për pedagogët por jo brenda të njëjtit institucion dhe jo të dyja punët me kohë të plotë.

Shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik; Marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit.

Numri i pedagogëve me kontratë në vitet akademike 2017-2018 ka ardhur në rënie dhe tenton të fitojë një lloj stabiliteti për vitin akademik 2018-2019. Ky është një tregues i mirë për mbulimin e ngarkesës mësimore nga pedagogët efektive, ndërkohë që lëvizja e shpeshtë e stafit akademik çënon cilësinë në mësimdhënie. Numri i pedagogëve efektivë është rritur nga 16 pedagogë në vitin 2017-2018 në 17 pedagogë në vitin 2018-2019. Ngarkesa mësimore e mbuluar nga pedagogët efektivë në programin “Financë-Bankë” ka variuar nga 50% të ngarkesës totale në vitin 2017-2018 në 70% në vitin akademik 2018-2019.

Mbështetur në të dhënat e dekluar në DVV, konkretisht Ngarkesa e stafit akademik, Evidenca 3.2, rezulton se maksimalja e ngarkesës së pedagogëve të brendshëm në këtë program është 150 orë (Dr. F. K) dhe minimalja është 30 orë.

Kriteret e rekrutimit të personelit akademik: Universiteti ka përcaktuar kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë kandidatët konkurrues për tu punësuar, si:

- diploma përkatëse;
- formimi i përgjithshëm arsimor dhe profesional;
- kualifikimi pasuniversitar (gradat shkencore ose titujt akademike);
- përvoja pedagogjike;
- zotërimi i aftësive të nevojshme personale për vëndin e punës.



Gjatë vizitës në institucion, grupi i ekspertëve të jashtëm, konstaton se kriteret nuk janë të plotë. Ato duhet të përfshijnë edhe mesataren e notës, të kandidatit, në studimet e nivelit bachelor dhe në studimet e nivelit Master. Gjithashtu në kritere duhet të përfshihet si kërkesë, edhe përvoja në mësimdhënie në fushën përkatëse.

Kandidati i perzgjedhur i është nenshtar një periudhe prove deri në 3 muaj, në mbarim të së cilës është përcaktuar nëse marrëdhënia e punës do të vazhdojë apo do të ndërpritet. Marrëdhënia e punës mes të punësuarit dhe universitetit rregullohet nga kontrata e punës, mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe në Kodin e Punës. Departamenti i Burimeve Njerezore administron dosjen e çdo antari të stafit akademik dhe atij administrativ, ku evidentohen edhe të dhenat në lidhje me levizjet dhe kualifikimet. Ky arkiv përditesohet çdo vit të ri akademik, apo semester me ndryshime që kanë ndodhur në kualifikimet dhe specializimet e stafit. Grupi i ekspertëve të jashtëm bëri verifikimin dhe kontrollin e disa dosjeve të cilat u përcaktuan mbi bazën e vërtetimit me zgjedhje.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Institucioni ka ndjekur procedurë publike, për rekrutimin e pedagogëve. Ai ka një politikë të caktuar lidhur me rekrutimet dhe strukturimin e stafit akademik. Kërkesat fillestare për rekrutim të stafit të ri, janë hartuar nga Departamenti, janë miratuar nga Këshilli i Fakultetit. Ky i fundit ka caktuar komisionin e vlerësimit të dosjeve.</p> <p>Njoftimet janë publikuar në faqen e ueb-it të Albanian University në TV, etj dhe më pas janë grumbulluar aplikime në muajt korrik/gusht të cilat shqyrtohen nga departamenti në muajin shtator. Komisioni i Vlerësimit pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe intervistave me aplikantët ka përzgjedhur kandidatët e përshtatshëm duke i propozuar miratimin e tyre, Dekanit të Fakultetit.</p> <p>Grupi i Ekspertëve të jashtëm vlerëson se pothuaj gjithë praktika e rekrutimit është e përqëndruar në kompetencat e Dekanit, i cili bën edhe kryesimin e komisionit të vlerësimit të kandidatëve dhe bën njëherësh edhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues, bën edhe emërimin. Këtu ka një non sens.</p> <p>Grupi i ekspertëve të jashtëm gjykon se kriteret nuk janë të plotë, dhe jo në të gjitha rastet kjo praktikë ka nxitur rekrutimin e stafit me mesatare të lartë, me formimin përkatës në funksion të fushës dhe lëndëve të kërkuara.</p> <p>Angazhimi dhe mbulimi i programit të studimit me staf akademik efektiv, ka ardhur në rritje nga viti në vit. Për vitin akademik 2018-2019, mbi 70 % të ngarkesës mësimore është mbuluar prej personelit akademik me kohë të plotë, të angazhuar në programin Bachelor ne Financë-Bankë.</p> <p>Vlerësimi i performancës së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore të pedagogëve zhvillohet gjatë gjithë vitit akademik. Ky vlerësim realizohet prej përgjegjësit të Departamentit, analizave vjetore, analizës së ngarkesave mësimore si dhe kërkesave të institucionit për progres</p>



	<p>akademik të pedagogëve. Njëkohësisht, institucioni organizon anketa me studentët për shprehjen e vlerësimit të tyre lidhur me mësimdhënien dhe punën e stafit.</p> <p>Opinionet dhe vlerësimet e studentëve për pedagogët, nuk njihet në të gjitha rastet dhe nga të gjithë pedagogët. Njohja me to, nuk është praktikë e rregullt pune. Një fenomen i tillë është vënë në dukje edhe në raportin e vlerësimit të grupit të eksertëve të jashtëm të hartuar në vitin 2017.</p> <p>Institucioni administron bazën e të dhënave të raporteve dhe procedurave të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj. që mbahet nga Zyra e Burimeve Njerezore.</p>
<p>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Zyra e BNP administron dosje të veçanta për çdo pedagog efektiv dhe të jashtëm, në të cilën gjenden: CV, titulli akademik përkatës, kualifikimet, dokumente mjeko-ligjore, etj.</p> <p>Zyra e burimeve njerëzore ka listën e plotë të personelit, të rifreskuar për çdo semestër dhe vit akademik. Po kështu zyra e burimeve njerëzore ka kontratat e punës të firmosura nga të dy palët.</p> <p>Universiteti ka publikuar në faqen zyrtare të institucionit dhe në kanalën televizive UFO TV, kriteret dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë.</p> <p>Të gjithë titullarët e lëndëve të angazhuar pranë Departamentit të Shkencave Ekonomike kanë së paku gradën shkencore “Doktor”. Rezulton se ka pedagogë me gradë shkencore doktor ose titull akademik që janë titullarë në më shumë lënde nga sa ata vetë japin mësim. Ndoshta kjo praktikë formale është nxitur nga institucioni për të përmbushur kërkesat e ligjit për Arsimin e Lartë në RSH.</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Institucioni ka një ekip mbështetës në funksion të procesit mësimor, ku përfshihet administrata qendrore, sekretaria, kancelaria, administrata në departament.</p> <p>Personeli ndihmës mësimor është i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorit të informatikës dhe pajisjeve kompjuterike, pasurimit të bibliotekës me literaturë të vazhdueshme, shpesh edhe në rrugë elektronike, etj.</p> <p>Laboratori i Informatikës, në programin Financë-Bankë përdoret për lëndën “Informatikë dhe Software Aplikativ”, dhe për tema të veçanta në lëndë të tjera si “Kontabilitet Financiar”, “Statistikë” etj.</p> <p>Laboratorët e informatikës, përdoren shumë pak për lëndët e formimit ekonomik, financiar dhe kontabilitet</p> <p>Fakulteti dhe Departamenti ka ekip me kualifikim të mirë pedagogësh dhe stafi mbështetës. Në përmbushjen e objektivave të studimit të ciklit të parë shihet një angazhim serioz i stafit pedagogjik.</p> <p>Ka përmirësime të ndjekjes së zhvillimit korekt të orës së mësimi dhe frekuentimit.</p>

	<p>Institucioni ka nevojë të përdorë metoda që synojnë motivimin dhe nxitjen e pedagogëve me shkallë më të mirë performance në procesin mësimdhënës dhe veçanërisht në punën dhe veprimtarinë kërkimore shkencore.</p> <p>Departamenti ka kapacitetet shkencore dhe njerëzore në dispozicion për të mbikqyrur praktikën mësimore dhe punimet e diplomave dhe të mikrotezave.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Veprimtaria trajnuese e fakultetit dhe e Departamentit ka qënë sa në funksion të njohjes dhe zbatimit të ligjit për Arsimin e Lartë në RSH, aq edhe në funksion të metodave të mësimdhënies dhe të formimit pedagogjik të stafit akademik.</p> <p>Ka pedagogë të veçantë që kanë marrë pjesë në konferenca apo projekte specifike kërkimore.</p> <p>Institucioni ka bazën e nevojshme të të dhënave për programin Bachelor në Financë-Bankë.</p>
<p><u>Konkluzione të GVJ:</u></p>	
<ul style="list-style-type: none"> • Institucioni ndjek një procedurë rekrutimi të stafit akademik të hapur, të mbështetur mbi kriteret përzgjedhëse, të bëra publike dhe konkurruese. Kriteret duhet të jenë më cilësore dhe më specifike. • Mbulimi i programit të studimit dhe të ngarkesës mësimore me staf akademik efektiv ka ardhur në rritje nga viti në vit. Në vitin akademik 2018-2019, kjo ngarkesë arrin 70 %. • Në ndonjë rast, është lejuar përzgjedhja e kandidatëve të papërshtatshëm, me notë mesatare jo të lartë për nivele akademike dhe që janë angazhuar në lëndë dhe fusha jashtë formimit të tyre bachelor dhe master. Ka raste kur rezulton të jetë i angazhuar me kohë të plotë si staf akademik personel që punon me kohë të plotë si personel administrativ. • Ka përmirësim të cilësisë së stafit të jashtëm të angazhuar me kontratë në procesin mësimor, në këtë program studimi. • Sikurse rezulton nga takimet me stafin dhe me studentët, stafi akademik, me kohë të plotë, nuk rezulton se është i informuar rregullisht lidhur me vlerësimin që bëjnë për ta studentët nëpërmjet procesit të anketimit dhe vlerësimit të procesit mësimor, megjithë që herë pas here ka një komunikim nga drejtuesit e departamenteve. 	

4. **Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residenat.

Ndërtesa në shërbim të Departamentit të Shkencave Ekonomike ka qënë ekzistuese. Ambientet e saj janë rikonstruktuar dhe janë adoptuar në klasa dhe laboratorë për të plotësuar nevojat e departamentit për çdo program studimi, me sipërfaqe totale rreth 4696.7 m². Infrastruktura e universitetit është e përshtatshme: ajo përmban klasa me hapësira të mjaftueshme, laboratorë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike për çdo program studimi. Universiteti ka salla konferencash, të pajisura me kompjuter, video projektor, ekrane të mëdha, flipcharte, etj, të cilat përdoren edhe nga Departamenti i Shkencave Ekonomike. Shiko anekse, Tabela 8

Rrjeti i kompjuterëve, që përdoren nga studentët, stafi akademik dhe punonjësit e administratës janë



të lidhur me internetin në të gjitha godinat e Albanian University. Fondi i bibliotekës pasurohet cdo fillim viti akademik, duke u bazuar në kërkesat që burojnë nga departamentet dhe nga studentët me literaturë profesionale si në gjuhë shqipe dhe ato të huaja; interneti është në dispozicion të orëve të studimit të studentëve, por edhe të kërkimit të pedagogëve.

Në fondin e Bibliotekës janë bërë përmirësime dhe është pasuruar fondin me libra profesionalë të botimeve të viteve të fundit dhe me autorë me reputacion shkencor dhe profesional, vendas dhe të huaj. Nga Bordi i Akreditimit është lënë detyrë pasurimi i fondit, çka GVJ konkludon se kjo kërkesë e Bordit është plotësuar.

Kopje të të gjitha teksteve bazë, në numër të kufizuar, janë siguruar gjithashtu edhe në fondin e bibliotekës së institucionit. Literatura e përdorur nga pedagogët është jo vetëm ajo e përcaktuar që në fillim të vitit si teksti shkollor lëndor bazë, por edhe burimet e tjera shtese si revista, lik interneti, etj. Institucioni shpenzon cdo vit fonde të planifikuara për blerjen e literaturës së specializuar për cdo program studimi dhe në fushën e kërkimit shkencor. Deri tani në fondin e bibliotekave të universitetit numërohen rreth 6000 libra, që u përkasin titujve të ndryshëm, ndër të cilat 228 vijnë në ndihmë të programit të studimit Financë-Bankë.

Veçori për Albanian University, për plotësimin e kërkesave për tekstet mësimore, është vënia në dispozicion e ndërmarjes botuese UFO-Press, në të cilën janë botuar të gjithë librat dhe tekstet mësimore për studentët. Studentët kanë mundësi të përfitojnë nga shërbimi i shitjes së librave që ju nevojiten pranë librarisë së universitetit por ata si dhe pedagogët mund të shfrytëzojnë dhe shërbimin e fotokopjes që ndodhet në këtë librari (Lista e botimeve ne Aneksin XIII).

Zyra e informacionit dhe e receptionit mundëson dhe shërbimin të çdo informacioni që kërkohet si nga ana e studentëve ashtu dhe personave të tjerë të interesuar, lidhur me programin mësimor, oraret, numrat e klasave etj. Po ashtu ndërtesa është e siguruar me roje të cilët shërbejnë gjatë të 24 orëve, si dhe është e pajisur me sistem kamerash vëzhguese në të gjitha hollat e kateve si dhe në mjedisin e jashtëm.

Për ushtrimin e aktiviteteve të tjera ekstrakurrikulare, si simpoziume, konferenca, seminare, leksione të hapura shkencore ka në dispozicion një auditor të madh i cili është i pajisur me të gjithë teknologjinë multimediale.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	Studentët e programit të studimeve Bachelor në Financë - Bankë, të Albanian University, përdorin dhe shfrytëzojnë fondin e bibliotekës të këtij universiteti, që ndodhet në godinën qendrore të universitetit dhe ofron shërbimet e saj edhe për Departamentin dhe studentët e ekonomisë dhe të financave.
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;	Biblioteka është e hapur, me orare të zgjatura, në përshtatje me kërkesat e studentëve dhe që ka qënë e pajisur me literaturën e përshkruar në syllabuset e lëndëve. Në bibliotekë ka botime të shumta dhe të kohëve të fundit me autorë vendas dhe të huaj. Universiteti ka pasuruar fondin edhe me botime të reja.
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;	Në bibliotekë ka një inventar dhe numër të konsiderueshëm librash dhe botimesh, në shqip dhe në gjuhë të huaj.
Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;	Në dispozicion të studentëve është edhe biblioteka online QUESTIA, për të cilën institucioni ka një abonim vjetor. Në bibliotekë disponohen tekste si në gjuhën shqipe dhe të
Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.	

	<p>huaj, që ndihmojnë realizimin e procesit mësimor. Në mënyrë të konsiderueshme ka ndihmuar edhe shtëpia botuese e Universitetit “UFO –Press”.</p> <p>Libraria elektronike mundëson shfrytëzimin e mjaft periodikëve të universiteteve dhe të programeve të studimeve të ndryshme, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës. Në bibliotekë gjenden botime periodike të revistës “Monitor”, Fletore zyrtare dhe broshura dhe raporte të Bankës së Shqipërisë.</p> <p>Biblioteka është e hapur, me orare të përshtatshme për studentët, me mundësi konsultash dhe që ofron njëherësh edhe mundësinë e përdorimit online.</p> <p>Oraret e studimit dhe të përdorimit të bibliotekës janë të shpallura në mjedise publike dhe janë hartuar duke marrë në konsideratë kërkesat dhe sugjerimet e studentëve.</p> <p>Titujt e librave dhe emrat e autorëve të botimeve të ruajtura në këtë bibliotekë janë të dixhitalizuar, nga vetë studentët, në kuadër të punimeve të tyre të kursit.</p> <p>Librat e bibliotekës së Universitetit nuk u lejohen studentëve të merren dhe të përdoren jashtë hapësirave të universitetit dhe jashtë sallës së bibliotekës. Në këtë mënyrë biblioteka humbet pjesërisht funksionin e një biblioteke. Studentët jo gjithnjë kanë mundësitë të përdorin dhe shfrytëzojnë librat e bibliotekës vetëm gjatë kohës që ata janë në ambjentet e universitetit.</p>
--	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit tëstudimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Institucioni ka një sasi të mjaftueshme të mjeteve audiovizive që i vijnë në shërbim. Infrastruktura e universitetit është e mirë: ajo përmban klasa me hapësira të mjaftueshme, të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike. Ndonjëherë auditorët janë shumë më të mëdha krahasuar me numrin e studentëve që ka secili grup mësimor.</p> <p>Universiteti ka salla konferencash, të pajisura me kompjuter, videoprojektor, ekrane të mëdha, flipcharte, etj. Klasat kanë raftë dhe tryeza pune modeste, të vendosura në formë rrethi, gjithashtu mjedise dhe auditorë për të lehtësuar si punën në grupe të mëdha, ashtu dhe atë në grupe të vogla. Të gjithë klasat mësimore janë të pajisura me mjetet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor ku përfshihen PC-të, projektoret dhe sistemi i fonisë.</p> <p>Pajisjet dhe programet e instaluar janë në funksion të procesit të mësimdhënies si dhe në përputhje me kërkesat e programeve dhe të syllabusave.</p> <p>Interneti është në dispozicion të orëve të studimit të studentëve, por edhe të kërkimit të pedagogëve. Universiteti ka sitin e vet dhe lidhjet me universitetet simotra në rajon e më gjerë.</p> <p>Videokasetat dhe CD janë pjesë e zhvillimit të orëve të ndryshme mësimore; pedagogët përdorin filma dhe</p>
---	--

dokumentarë si pikënisje e debateve dhe diskutimeve për një temë mësimore.

Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit dhe objektivat e tij. Në funksion të këtij programi studimi sallat janë të pajisura me video projektor, lidhje me internetin wireless, etj.

Numrin i lëndëve që zhvillohen në këta laboratorë, që konsistojnë me përdorimin e teknikës dhe të teknologjisë është mjaft i ulët. Përjashtuar lëndën e programeve të kontabilitetit të informatizuar, laboratorët nuk përdoren për lëndë të tjera të formimit profesional ekonomik.

Universiteti ka në përdorim, në mjediset e ndërtesës, në të cilën realizohet, programi i studimit Finance-Bankë një laborator informatike i cili i ndihmon pedagogët dhe studentët gjithashtu të realizojnë programin dhe detyrimet e tyre. Studentët nuk kanë gjithnjë mundësi të përdorin laboratorin për punët dhe detyrat që kanë në lëndët e kurrikulave të ndryshme apo dhe në temat e diplomave. Po kështu ata nuk mund të printojnë apo bëjnë punë të pavarura jashtë orës së mësimit në laboratorët e shkollës.

Laboratori ka mundësi që t'ju shërbejë disa programeve të studimit, sipas një skedulimi normal të orarit të punës.

Institucioni disponon laboratore me hapësira të nevojshme dhe të kompletuar për të gjitha programet e studimit.

Studentët e programit Bachelor në Financë-Bankë, bëjnë praktika profesionale pranë bizneseve të ndryshme, bankave, apo institucioneve shtetërore si Drejtoria e Tatimeve etj.

Ndjekja e praktikave mësimore prej stafit akademik si dhe mirëpritja apo integrimi i studentëve të pranuar në praktikat mësimore, nuk është gjithnjë e garantuar dhe kjo nuk premtion për cilësinë dhe pritshmërinë e duhur që ka institucioni, studentët dhe kërkesat e programit. Ky përfundim është evidentuar edhe në raportin e vlerësimit të ekspertëve të jashtëm në vitin 2017.

Bashkëpunimi dhe partneriteti me bizneset private apo publike është i limituar.

Konkluzione të GVJ:

- Institucioni posedon infrastrukturën e nevojshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor, në përputhje me kërkesat e studentëve dhe me numrin e të regjistruarëve. Infrastruktura e universitetit është e kohës: ajo përmban klasa me hapësira të mëdha, të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike. Universiteti ka sallat konferencash, të pajisura me kompjuter, videoprojektor, ekrane të mëdha, flipcharte, etj.
- Ka një bibliotekë me literaturën e rekomanduar në syllabusa, në të cilën ka një fond botimesh në shqip dhe në gjuhë të huaj, në trajtë hard copy dhe elektronike.
- Grupi i ekspertëve të jashtëm konstaton se numri i titujve, botimeve, revistave shkencore dhe periodike, hard copy dhe online, vazhdon të jetë i limituar. Po kështu edhe përdorimi i laboratorit të informatikës për lëndët e formimit profesional dhe specifik në fushën e Financë-Bankës, është i kufizuar.
- Nga kontaktet me studentët doli se praktikat e tyre nuk ndiqen nga stafi akademik në ndërmarrjet apo institucionet në të cilat ata kryejnë praktikat mësimore

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Sikurse është shkruar dhe shpjeguar edhe në raportin e vlerësuesve të jashtëm, të hartuar në vitin 2017, burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe aktivitete të tjera tregtare të përmendura më poshtë. Të ardhurat nga tarifat e shkollimit shkojnë edhe për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese. Në rang universiteti ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare, dhe kontrollin e tyre të përmendura më poshtë tek kriteret. Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor (për të gjitha vitet e kaluara) të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm të fushës së kontabilitetit dhe financës.

Burimet financiare janë ato që lidhen me tarifat e shkollimit të studenteve. Shiko Aneks, Tabela 9. Rreth 1/3 e këtyre burimeve të të ardhurave shpenzohet për qiranë e objektit dhe shërbime të tjera të lidhura me të (mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja etj.). Pjesë tjetër e burimeve të të ardhurave shpenzohet për pagesën dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, shërbimin internet, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit.

Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKB.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij; Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj; Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Institucioni, si pjesë e shoqërisë tregëtare, UFO Shpk, bën audit financiar dhe kontabël të përvitshëm, nga një Ekspert Kontabël i Rregjistruar, i liçencuar dhe i regjistruar, për situatën financiare, për raportin dhe pasqyrat financiare. Raportet e të cileve ndertohen sipas standardeve perkatese. Raporti i auditit të brendshëm dhe të jashtëm është në përputhje me kriteret profesionale të fushës dhe një kopje e raportit vjetor është depozituar në strukturat respektive shtetërore. Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet dhe të ardhurat (duke iu referuar bilancit). Raportet e auditit analizojnë eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve të ciklit të parë të studimeve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh. Raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet, theksojmë se aktualisht universiteti nuk përfiton asnjë grant të huaj që përfitohen nga kontratat e shërbimeve.
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;	Institucioni harton rregullisht raportin financiar dhe pasqyrat financiare të shoqërisë UFO, Shpk, për çdo vit buxhetor (për dy vitet e kaluara kalendarike dhe ushtrimore

Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;
Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

përkatësisht për vitin 2017, dhe 2018, që janë vite për të cilat kryhet vlerësimi nga ekspertët e jashtëm për programin e studimeve Bachelor në Financë-Bankë), certifikuar nga eksperte të jashtëm, sipas kërkesave të shërbimit të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Ekspertët e fushës e kanë hartuar dhe firmosur. Raporti përmban të dhëna për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative etj. Raporti disponohet nga zyra e financave të universitetit dhe është depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, (QKB) dhe Drejtoria Rajonale Tatimore.

Institucioni i ka të dokumentuara raportet financiare për të dy vitet e fundit ushtrimore.

Nga dokumentat e performancës financiare rezulton se situata e derisotme financiare dhe bankare dëshmon se Institucioni ka qëndrueshmëri të mirë financiare, ka aftësi relativisht të mirë paguese, përmbush në afat detyrimet dhe shlyen brënda afateve të deklaruara detyrimet ndaj stafit akademik të brëndshëm dhe të jashtëm si dhe detyrimet e tjera infrastrukturore të universitetit.

Konkluzione të GVJ:

- Universiteti, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike si dhe Departamenti i Shkencave Ekonomike, kanë burimet e nevojshme financiare që garantojnë vazhdueshmërinë dhe ecurinë normale të Programit Bachelor në Financë/Bankë.
- Financimi dhe të ardhurat për departamentet e Arkitekturës, Shkencave Ekonomike dhe Inxhinierive janë pjesë e informacionit dhe të dhënave të Albanian University. Konstatohet niveli konstant i të ardhurave (shpesh në vitet e fundit dhe me rritje të ndjeshme), gjë që tregon për një stabilitet edhe në vazhdim të aktivitetit akademik dhe shkencor të universitetit. Institucioni ka qëndrueshmëri financiare.
- Fondet në dispozicion të Departamentit për veprimtarinë kërkimore dhe shkencore vazhdojnë të jenë minimale. Departamentet kanë bërë shumë pak aplikime për të fituar financime lidhur me aktivitetin e tyre shkencor dhe akademik.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Universiteti ka ngritur strukturën e qajtur: Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë të nxjerra nga ASCAL. Kjo zyrë ka filluar të funksionojë qysh prej vitit 2009.

Kontrolli i sigurimit të cilësisë, në këtë institucion është mbështetur në dy linja: Nga njëra anë te veprimtaria e zyrës së posaçme të sigurimit të cilësisë, si shërbim që varet direkt nga Rektori i Universitetit dhe monitoron gjithë veprimtarinë, dhe nga ana tjetër, në çdo Departament, ka një grup pedagogësh, të cilët përgjigjen dhe ndjekin veprimtarinë që ka të bëjë me cilësinë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Funksionet dhe detyrat e zyrës janë të parashikuara dhe të shprehura në rregulloren e brëndëshme të Universitetit.

ZSBC funksionon edhe në nivel njësie bazë, pra departamenti. Shiko Anekse, tabela 10. Kështu në nivel departamenti, me asistencen e Zyres se Kurrikulave, para cdo fillim viti te ri akademik, gjatë procesit të mësimdhënies, dhe në përfundim të tij analizohen dhe vleresohen programet mësimore, literatura dhe format e vleresimit. Kontrolli dhe vleresimi bëhen në bazë të:

- të dhënave statistikore, të mbledhura gjatë anketimeve të studentëve (Aneksi XV),
- raporteve semestrale të pedagogëve (Aneksi XVI),
- raporteve semestrale dhe vjetore të departamenteve,
- rezultateve të arritura nga studentët.

Këto të dhëna statistikore vihen në dispozicion të ZSBC nga Departamenti & sekretaria mësimore. Departamenti ka analizuar disa herë procesin mësimor, ngarkesat e pedagogëve dhe problematikën që ka dalë sipas informacioneve nga ZSBC dhe nga grupi i pedagogëve.

Zyra e brëndëshme e Sigurimit të cilësisë, NJBSC, organizon si rregull një anketim me studentët, të cilët janë pyetur mbi: metodat e mësimdhënies, format e leksioneve, shpjegimin e qartë dhe të kuptueshëm, respektimin e etikës, komunikimin, objektivitetin në vlerësim të punimeve, detyrave, dhe provimeve, komunikimin e stafit administrativ, për sjelljet korruptive të mundshme, etj. Universiteti ju kërkon gjithashtu studentëve të shprehën për dy pika të forta, dhe dy pika të dobëta, të këtij universiteti dhe në se do tja rekomandonin edhe dikujt tjetër që të ndiqte studimet në këtë universitet.

Në dy vitet e fundit akademike në hapësirën 2017-2019, janë pyetur rreth 37 % e studentëve të programit të studimit Bachelor në Financë/Bankë. Të dhënat e anketave janë përpunuar nga ZBSC dhe rezultatet ju janë përcjellë organeve më të larta drejtuese. Nuk rezulton që stafi akademik efektiv dhe me kontratë, të njohin periodikisht opinionin e shprehur nga studentët në anketimet e bëra me ta. Po kështu studentët u shprehën se jo gjithnjë ata janë intervistuar dhe kanë plotësuar pyetësorë lidhur me vlerësimin e cilësisë dhe me mbarëvajtjen e programit të studimeve Bachelor në Financë-Bankë.

Në anketimet, studentët kanë shprehur shqetësimet lidhur me:


- penalizimin për shkak të mungesave dhe të mosndjekjes së studentëve të leksioneve e seminareve,
- hapësirave të kufizuara për studim,
- mungesa e shërbimit të sekretarisë online,
- mospërfshirjen e studentëve në veprimtari kërkimore,
- numrin e kufizuar të titujve të librave në gjuhën shqipe,

Këto shqetësime janë relatuar nga ZBSC dhe janë trajtuar edhe nga Rektorati.

GVJ konstaton se është rritur nota mesatare e studentëve që janë pranuar në vitin e parë të studimeve në programin e studimeve Bachelor në Financë-Bankë. Kjo vjen edhe për shkak të rritjes së pragut të mesatares të vendosur nga Ministria e Arsimit dhe Rinisë.

Në programin e studimeve Bachelor në Financë-Bankë ka një numër të konsiderueshëm transfertash të studimeve nga ana e studentëve që vijnë në këtë universitet nga shkolla të tjera të larta. Nuk ka asnjë rast që e drejta e transferimit të studimeve në këtë program studimesh të jetë refuzuar. Transferimet e studimeve janë bërë me dokumentacion të plotë, ndërkohë që gjykojmë se duhen përdorur filtra më rigorozë në përdorimin e të drejtës së transferimit.

Vlerësimi sipas Standardeve



Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<p align="center">II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p>	<p>Institucioni ka hartuar programin e studimeve Bachelor në Financë-Bankë në përputhje me kërkesat akademike, shkencore dhe profesionale, që respekton linjat kryesore të formimit profesional dhe që ka ngjashmëri me të njëjtat programe të hartuar në shkollat e tjera të karta të të njëjtës linjë në vëndin tonë.</p> <p>Institucioni ka bërë dhe bën analiza në Departament dhe përgjegjësi i Departamentit apo drejtuesit e Fakultetit bëjnë vlerësimet e tyre periodike.</p>
<p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. 	<p>Institucioni nuk ka marrë vlerësim nga partnerët dhe nga tregu në fushën e financës dhe të bankës, apo nuk ka organizuar forume apo aktivitetet për të testuar performancën në praktikë të diplomave, për cilësinë dhe nivelin e të diplomuarëve nga ky program të punësuarëve në ndërmarrje dhe institucione të ndryshme.</p>
<p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Etj. 	<p>Zyra e brendëshme e kontrollit të cilësisë që funksionon brenda institucionit, ka për mision kontrollin e cilësisë, të cilën e realizon nëpërmjet analizave, raporteve të departamenteve dhe pyetësorëve.</p> <p>Pjesë e kësaj analize janë edhe marrëdhëniet student/pedagog, staf akademik/administratë, departament/administratë, etj. për të evidentuar kontributin dhe mangësitë e cdo hallke të përfshirë në mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>Pjesërisht, institucioni në raporte vjetore, publikon rezultatet e pritshme, dhe rezultatet që synon të arrijë në fushën e kontrollit të cilësisë, por këto nuk janë gjithnjë të aksesueshme për publikun dhe për studentët.</p> <p>Lidhur me programin e studimeve Bachelor në Financë-Bankë, kanë funksionuar fokus grupet e përbëra nga pedagogë të departamentit dhe studentë, pyetësorët dhe format e bashkëbisedimit me studentët, etj, të cilat kanë prekur dhe trajtuar elementë të veçantë të programit të studimeve.</p> <p>Institucioni nëpërmjet ZSBC-sëka përdorurmetoda të drejtpërdrejta dhe mjete tërthore vlerësimi si: dëgjimi në auditor, vlerësimi me nota, teste paraprake dhe përfundimtare, statistikën për kalueshmërinë, analizat e syllabusave, etj. Po kështu realizohen edhe bashkëbisedime dhe anketime.</p>
<p align="center">VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Sikurse është shkruar dhe shpjeguar edhe në raportin e vitit 2017, për këtë program studimi, institucioni ka një manual për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të miratuar nga APAAL. Në manual janë të përfshira metodat, dhe format që duhet të përdorë për kontrollin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Departamenti, edhe pse në raportin e vetvlerësimit të brendshëm, thuhet se është organizuar dhe strukturuar në grupe të lëndëve mësimore, nuk rezultojnë që të paktën grupet e lëndëve mësimore të jenë efektive. Pedagogët nuk kishin dijeni se kujt grupi ju përkisnin.

Institucioni ndjek periodikisht vlerësimin nëpërmjet raporteve të vlerësimit dhe pyetesorëve në përfundim të çdo semestri.

Departamenti dhe Fakulteti përdorin mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herë të programeve të studimit, të sanksionuara këtu në rregulloret e programit të studimit dhe akteve të tjera normative, sikurse edhe nga procedura e punës vjetore e departamentit.

Në funksionimin e Departamentit ka përmirësime të dukshme të karakterit akademik dhe organizativ. Por, gjykojmë se vazhdon të mungojnë analizë e diferencuar, transparente, që evidenton performancën e secilit pedagog në mësimdhënie, të çdo programi lënde, si dhe përcakton drejtimit e përmirësimit të procesit në vijueshmëri.

Institucioni përfshin në mënyrë të gjërë pedagogët dhe studentët në procesin e kontrollit të cilësisë, nëpërmjet diskutimeve, anketimeve, analiza, etj, çka i bën ata të ndërgjegjshëm për procesin dhe domosdoshmërinë e kontrollit të cilësisë;

Institucioni ka një strategji të përgjithëshme, në të cilën përfshihen objektivat dhe synimet. Institucioni nuk ka hartuar një strategji të vecantë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Konkluzione të GVJ:

- Institucioni ka struktura organizative që kanë për mision kontrollin dhe ndjekjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies.
- Ana metodike, analiza, anketimet dhe procedurat janë duke u konsoliduar në rang institucioni.
- GVJ gjykon se transferimet e studimeve nga një fakultet tjetër në këtë institucion ka nevojë për një vlerësim më objektiv dhe për të ndërtuar raporte më të drejtamidis të regjistruarëve dhe të të transferuarëve. Jo të gjithë ata që kërkojnë të transferohen mund të pranohen.
- Institucioni ka nevojë të realizojë studime për cilësinë, krahasuese me diploma dhe programe të ngjashme ose të njëjta në treg. Vlerësimi i cilësisë së programit, nëpërmjet cilësisë së të diplomuarëve të punësuar, prej partnerëve dhe prej tregut, nuk është një praktikë e rregullt pune.

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj.

Programi i studimit Bachelor në Financë dhe Bankë, ofrohet krahas programeve të tjera të studimit që realizon Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, në Albanian University. Programi i studimit Bachelor në "Financë-Bankë" synon të krijojë njohuritë teorike, aftësitë praktike dheformimin e kompetencave dhe shprehive të nevojshme për specialistë të lartë të sektorit financiar dhe bankar, menaxherë dhe konsulentë në këto sektorë në përshtatje me nevojat e tregut të punës. Ky program synon të nxisë dhe të zhvillojë të menduarit kritik dhe thellimin e njohurive të studentëve, nëpërmjet metodologjive të ndryshme të mësimdhënies, zgjidhjes së problemeve krahas njohjes së studentëve me zhvillimet më të fundit në fushën e menaxhimit, strategjisë, marketingut, financës, etj

Disiplinat që ofrohen janë në fushat ekonomike, juridike, financiare, manaxheriale, matematike e statistike, por edhe informatike, gjuhe e huaj dhe praktikë profesionale. Programi i studimit ka për qëllim kompletimin e njohurive dhe shprehive të transmetuara studentëve dhe harmonizimin e tyre, për të mundësuar përgatitjen e studentëve të ciklit të parë për tregun e punës sipas profilit, por edhe për të krijuar mundësi për vazhdimin e mëtejshëm të studimit në programe të të njëjtit lloj apo në programe të ngjashme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe avancimin e studimeve në nivelin Master i Shkencave apo Master Profesional, duke mundësuar më mirë kështu mobilitetin e studentëve dhe stafëve akademike.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Përmbajtja e programit:


Programi i studimit "Financë-Bankë" është program studimi i nivelit të parë (Bachelor). Ai është i organizuar në tre vite akademike me nga 60 ECTS në vit, për një total prej 180 ECTS. Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese të programit janë të organizuara në 6 kategori, (Shiko Anekse, tabela 11) si më poshtë:

- | | |
|--|------------|
| 1. disiplina të formimit bazë | (32 ECTS) |
| 2. disiplina të formimit karakterizues | (97 ECTS) |
| 3. disiplina të ndërdisiplinore ose integruese | (26 ECTS), |
| 4. disiplina plotësuese | (19 ECTS) |
| 5. detyrime përmbyllëse | (6 ECTS) |

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit është organizuar në gjashtë semestra, për tre vite. Në të përfshihen lëndët, modulet, kreditet dhe orët për çdo kredit, në auditor dhe jashtë auditorit. Po kështu në program janë përcaktuar edhe materialet mbështetëse dhe literatura për secilën lëndë. Numri i krediteve sipas semestrave paraqitet në Tabelën nr 12, në Ankes.

Shpërndarja e lëndeve sipas viteve dhe semestrave, është bërë duke u mbështetur në një sistem të mësuarit që kalon nga formimi i përgjithshëm të formimit bazë profesional dhe formimi i veçantë profesional, të harmonizuara me disiplinat mbështetëse.



Viti akademik është organizuar në semestra dhe çdo semestër është konceptuar dhe organizuar nga 15 javë mësimore në auditor. Oraret dhe programi ekzekutohen nëpërmjet orareve të ndërtuara sipas kësaj shpërndarjeje:

- Viti akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- Viti akademik ka dy semestra
- Një kredit, është llogaritur me 25 orë mësimore në auditor dhe punë e pavarur e studentit,
- Ora mësimore është llogaritur me 50 minuta

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Programi i studimit dhe kreditet janë të transferueshme dhe Universiteti pranon studentë që vijnë nga programe të njëjta të universiteteve të tjera, si dhe studentët e këtij programi mund të transferohen në fakultete të tjera të shkollave të tjera të larta.

Në mënyrë më të detajuar, shpërndarja e lëndëve sipas viteve akademike, orëve në auditor dhe numrit të krediteve, prezantohen në tabelën nr. 13 në Aneks.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Programi i Studimit BSc në Financë-Bankë	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	885
Seminare	263
Ushtrime	570
Detyrë/Projekt	29
Praktikë	80
Total	1827

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Aneks, Tabela 14)

Mbështetur në RVB, Ekspertët e jashtëm konstatojnë se janë bërë ndryshime në planin mësimor që nga koha e licensimit të këtij programi studimi. Ndryshimet kanë konsistuar edhe në përshtatjen e planit mësimor sipas VKM Nr 41, datë 24.01.2018. Ndryshimet deri në masën 20% në planin mësimor janë bërë më Vendim Senati Akademik Nr 16, datë 25.04.2018. Për këto ndryshime është marrë miratimi edhe Nga Sekretari i Përgjithshëm i MASR, me shkresë Nr 4932/1 Prot, datë 05.06.2018 “Kthim përgjigje” (Evidence Nr 7.2.1 e DVV)

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Aneks, Tabela 15)

Siç edhe e kemi paraqitur më lart, si dhe mbështetur në takimet e realizuara gjatë vizitës, vërehet se 70% e lëndëve (ngarkesa në orë) mbulohet nga personeli i brendshëm i Institucionit.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën

- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse


Për secilën lëndë ka një syllabus. Në to shpjegohen në detaje, vëllimi i orëve në auditor, dhe jashtë auditorit, ndarë në lëksione dhe seminare. Gjithashtu në to shpjegohen: Emërtimi i lëndës/modulit, Viti/semestri kur zhvillohet lënda, emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, grada dhe titulli që ka pedagogu, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës, niveli i njohurive që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, format e vlerësimit të studentëve, detyrimet e studentit për lëndën, literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse, etj.

Departamenti shkencave ekonomike bashkëpunon me Grupin e Cilësië në nivel departamenti në përditësimin e syllabuseve në përputhje me të rejat më të fundit në lëndët përkatëse, si dhe në përditësimetë literaturës, kur është e nevojshme. Kryesisht, literatura e detyruar është shqip. Në rastet kur kjo literaturë mungon, pedagogët kanë përgatitur lëksione të parashkuara.

Në kuadër të ndryshimeve në përputhje me ligjin e ri të arsimit të lartë 80/2015, siç përmendet edhe në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti i Shkencave Ekonomike ka krijuar grupet mësimore dhe ka zgjedhur drejtues për secilin grup, të cilët ndër të tjera do të mbikëqyrin edhe përditësimin korrekt të syllabuseve të lëndëve të grupeve përkatës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi është licencuar me Urdhër nr. 8981, datë 27.12.2005 dhe është akredituar me kusht me Urdhër nr. 355, datë 03.11.2009 në bazë të VKA nr. 50, datë 27.10.2009. Programit ju hoqen kushtet e akreditimit me Urdhër të Ministrit nr. 541, datë 01.12.2010. Akreditimi i fundit për programin është dhënë nga Bordi i Akreditimit me Vendim nr. 85, datë 21.09.2017 dhe këtë vit programi i nënshtrohet akreditimit periodik.</p> <p>Numri i krediteve që grumbullohet për çdo vit akademik është 60 ECTS dhe për gjithë programin tre vjeçar të studimit është 180 ECTS.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet</p>	<p>Gjatë javës së parë të pranimit të studentëve, Fakulteti dhe Departamenti japin informacion të detajuar lidhur me</p>



e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;

Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

programin e studimeve Bachelor në Financë/Bankë përsa i përket kurrikulës, orarit, krediteve, kalendarit akademik dhe njesite ku ata mund të drejtohen për informacione dhe kërkesa të ndryshme. Ky informacion vihet në dispozicion nëpërmjet manifestit akademik, në ambientet e universitetit dhe në faqen eeb të universitetit.

Departamenti përkatës dhe sekretaria mësimore japin informacion të detajuar në lidhje me lëndët me zgjedhje apo të detyruara për çdo semestër, kryesisht për studentët e vitit të parë.

Departamenti përkatës dhe sekretaria mësimore japin informacion të detajuar dhe në lidhje me ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, detyrimet gjatë vitit, etj.

Çdo student ka të drejtën e informimit në lidhje me përmbajtjen e lëndës, ndaj çdo pedagog në orën e parë të semestrit ju shpërndan studentëve syllabusin e lëndës, qoftë në formë elektronike ose të printuar. Gjithashtu, ata njihen dhe me rregulloren mësimore, duke u informuar në lidhje me detyrimin e ushtrimit të praktikës, periudhën e kryerjes së saj, detyrat e kursit, orët e laboratorit, pikët për secilën kategori të mësipërme, etj.

Konkluzionet e GVJ:

- Programi i studimeve Bachelor në Financë-Bankë, është ndërtuar sipas kërkesave të Deklaratës së Bolonjës, me kërkesat për kreditet gjithsej, ndarjen sipas viteve dhe semestrave, numrin e orëve për një kredit, raportin midis orëve në auditor dhe jashtë autorit, raportin midis orëve në disiplinat e formimit të përgjithshëm, si dhe atyre të formimit të përgjithshëm profesional dhe formimit profesional të veçantë, për financën dhe bankat.
- Departamenti kujdeset në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit që ofron, si dhe përditësimin e syllabuseve të lëndëve pjesë e tyre.
- Studenti ka aksesin e nevojshëm për të marrë në mënyrë të vazhdueshme të gjithë informacionin e nevojshëm për ta, në formë të shkruar, nga njësia bazë, njësia kryesore apo nga sekretariatë mësimore.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësive etj.

Në programin BSc në Financë-Bankë procesi i mësimdhënies zbatohet sipas syllabusit të çdo lëndë dhe me lirinë përkatëse të personelit akademi, të cilët e organizojnë procesin mësimor sipas komponentëve të shprehur në syllabus. Gjatë mësimdhënies, pedagogët përdorin mjete didaktike të tilla si: video projektorë, slide, tekste shtesë, raste studimore, etj.

Në rregulloren mësimore të programit të studimit, si dhe në syllabuset përkatëse përcaktohet mënyra e kontrollit të njohurive të studentëve.

Kontrolli i njohurive realizohet me forma të ndryshme, të ndërthurura dhe të shtrira në kohë, përgjatë semestrit dhe vitit akademik, në përputhje me rregulloren mësimore të programit të studimit. Çdo lëndë kontrollohet dhe vlerësohet nëpërmjet dy elementëve kryesore: vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi në fund të semestrit, me provimin e lëndës. Vlerësimi i vazhduar realizohet nga detyrat e kontrollit, nga punimet e kursit, nga testimet

gjatë vitit, nga pjesëmarrja dhe aktivizimi. Vlerësimi i studentëve bëhet me nota, me sistemin me dhjetë nota si dhe me gërma (Tabelat nr. 16 dhe nr. 17, në Aneks).

Mësimdhënia organizohet në këto forma kryesore: leksionet, seminarët/ushtrimet, laborator, detyrat e kursit/projektet dhe praktikë mësimore, të organizuara në 22 module, ku janë parashikuar 20 provime, praktika profesionale dhe tema e diplomës/provimi i formimit.. Gjitashtu, lëndët klasifikohen sipas disiplinave përkatëse, si dhe të ndara në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje.

Struktura e këtyre elementëve, përbëhet si vijon:

- Leksione 48.5 %
- Seminarët 14.5 %
- Ushtrime 31 %
- Detyrë/Projekt 1.6 %
- Praktikë 4.4 %

Pedagogët, në fillim të çdo semestri, hartojnë programin e lëndëve, ku përfshihen, qëllimet, objektivat, koha e realizimit, kreditet, temat që do trajtohen dhe plani kalendar i zhvillimit të orëve mësimore.

Vlerësimi i mësimdhënies kryhet nga Departamenti dhe NJSBC nëpërmjet pyetësorëve dhe montorimeve. Është e detyrueshme që nga ana e çdo pedagogu dhe nga ana e vetëdepartamentit të bëhet një raport semestral (raport tip) në lidhje me cilësinë e mësimdhënies. Në fund të semestrit realizohet anketa e studentit ku vlerësohet personeli akademik sipas disakritereve të përfshira në pyetësorin e vlerësimit.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Procedurat e pranimit te studenteve

Në ciklin e parë të studimjeve, siç përmendet edhe në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, pranimi bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, mbi akte të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë në fuqi, mbi rregulloren e programit dhe rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve.

Programi i studimit BSc në Financë-Bankë i drejtohet studentëve, të cilët kanë notën mesatare ≥ 6 , sipas përcaktimit me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe kanë përfutur njërën nga diplomat e mëposhtme:

1. Maturën shtetërore;
2. Diplomën e shkollës së mesme (të përgjithshme ose të profilizuar, sistemi i vjetër);
3. Diplomë e shkollës së mesme profesionale 5 vjeçare;
4. Dëftesa e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlefshme me të në Shqipëri.

Në vitin akademik 2017 – 2018 janë regjistruar 29 studentë për herë të parë në vitin e parë me mesatare hyrëse 7.56, dhe 17 studentë të transferuar në vitet e ndërmjetme. Gjatë këtij viti u diplomuan 100 studentë. Në vitin akademik 2018 – 2019 u regjistruan 57 studentë për herë të parë në vitin e parë me mesatare hyrëse 7.36, dhe 11 studentë të transferuar në vitet e ndërmjetme. Për këtë vit, sesioni i diplomimit do të zhvillohet në përfundim të sesionit të provimeve të verës.

Universiteti ka hartuar disa kriteret specifike pranimi, të cilat janë kompozuar si vijon: 70% mesatarja e përgjithshme dhe 30% mesatarja e grup lëndëve përkatësisht, 15% Ekonomia, 10% Matematika dhe 5% Anglisht. U njohet e drejta për të aplikuar në këtë program studimi shtetasve shqiptarë të pajisur me dokument

zyrtar të përfundimit të shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalente sipas kritereve të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit). Të drejtën për të aplikuar për pranimin në ciklin e parë të studimeve e kanë edhe studentët e huaj, bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe.

Dokumentet që duhen të paraqesin studentët janë:

- Diplomë e maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave;
- Deftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit;
- Dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011);
- Fotokopje e kartës së identitetit, letër njoftimit ose pasaportës;
- 2 fotografi;
- Formulari i aplikimit.

Cilësia në hyrje e studenteve. Numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite; koha mesatare e zgjatjes së studimeve:

Sipas rregullores së programit të studimit, kohëzgjatja e studimeve në programin BSc në Financë-Bankë është 3 vite akademike (6 semestra), të cilave u korrespondojnë 180 kredite ECTS. Forma e studimit është me kohë të plotë dhe frekuentimi i aktiviteteve formuese në auditor është i detyrueshëm në të paktën 75% të seancave. Afati maksimal i përfundimit të studimeve të plota është 6 vite akademike (dyfishi i afatit të rregullt) pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet. Siç përmendet edhe në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, studenti mund të vijojë pjesëmarrjen në program mbi kohën e rregullt të studimeve, kur shlyen detyrimet sipas planit mësimor dhe paguan tarifën përkatëse. Gjithashtu, studenti lejohet të regjistrohet në vitin pasardhës, kur ka fituar të paktën 50% të krediteve të detyrueshme të vitit paraardhës. Lëndët të cilave u përkasin kreditet e mbetura konsiderohen detyrime të mbartura. Departamenti, në zbatim të rregullores së Fakultetit, përcakton kushtet dhe rendin e shlyerjes së detyrimeve të mbartura për fitimin e krediteve të mbetura.

Ecuria e të rregjistruarve në programin e studimeve Bachelor në Financë-Bankë, për 2 vitet e fundit, paraqitet në tabelën nr.18.

Të dhëna më të detajuara për studentët të cilët frekuentojnë këtë program studimi në të tre vitet akademike; 2016-2017; 2017-2018 dhe 2018-2019 e gjeni në Aneks tabelë 19.

Sipas kësaj tablele, numri i studentëve të rregjistruar në dy vitet akademike, pjesë e vlerësimit të GVJ është: studeentë të rregjistruar për herë të parë në vitin e parë në 2017-2018 është 29 studentë; ndërsa në vitin 2018-2019 është 57 studentë. Numri i studentëve të rregjistruar për herë të parë dhe të transferuar ndër vite, për vitin akademik është 46 studentë dhe në vitin akademik 2018-2019 është 68 studentë.


Ndërsa për një cikël të plotë studimi (2016-2017; 2017-2018; 2018-2019) totali i studentëve (të rregjistruar për herë të parë së bashku me transferimet) është 299 studentë.

Këto të dhëna GVJ ju dhanë gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore. Vërehet një numër në total i lartë i studentëve të transferuar, numër i cili ka ardhur duke u ulur në vitet akademike 2017-2018 dhe 2018-2019, vite të cilat janë objekt vlerësimi i GVJ.

Kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të:

Studenti nuk pranohet në sesionin e parë të provimit të një lënde kur ka kryer më shumë se 25% mungesa në seancat mësimore të asaj lënde. Nëse ka kryer deri në 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës atëherë ai pranohet në sesionin e dytë, dhe nëse ka kryer mbi 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës shpallet përsëritës në atë lëndë.

Departamenti i Shkencave Ekonomike përfshin në Raportin Vjetor të dhëna konkrete për kalueshmërinë e studentëve, të specifikuar sipas viteve dhe lëndëve përkatëse.



Komunikimi me ish-studentet e diplomuar (ALUMNI):

Komunikimi me ish studentët bëhet nëpërmjet departamentit dhe Zyrës së Zhvillimit të Karrierës, por duhet të theksohet që ky i fundit nuk është gjithë përfshirës. Kontaktet me ish të diplomuarit kanë qenë të dobëta. Formimi profesional i vazhduar i tyre nuk ndiqet nga fakulteti, pas diplomimit. Kontaktet realizohen vetëm për ata studentë që zgjedhin të qëndrojnë në kontakt me departamentin.

Punësimi i të diplomuarve:

Departamenti nuk ka informacion të detajuar dhe gjithëpërfshirës ndër vite për punësimin e të diplomuarve. Megjithatë, për vitet 2017-2019, në lidhje me programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë, disponohet informacioni se nga 102 të diplomuar, 35 % prej tyre janë punësuar në përputhje me diplomën dhe 25 % prej tyre janë punësuar jo në përputhje me diplomën.

Procedurat e transferimeve të studimeve

AU mundëson transferimin e studentëve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të parë, midis programeve të njëjta ose të ngjashme studimi, si brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, private ose publike, vendase ose të huaja, si dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkolla të tjera të arsimit të lartë sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e programit dhe në rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve.


Programi BSc në Financë-Bankë krijon mundësi të mira transferimi në programet ekonomike të ngjashme të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat në vend. Nëpërmjet marrëveshjes Erasmus + KA1 të departamentit të Shkencave Ekonomike 1 (një) student e programit BSc në Financë-Bankë ka zhvilluar një semestër në Kolegjin Powislanski në Kwidzyn Poloni.

Studentët që dëshirojnë të transferohen në Albanian University (studentë në hyrje) paraqesin nje dosje aplikimi pranë Zyrës së Regjistrimit të Studentëve të Albanian University. Dosja e çdo studenti që pranohet, shqyrtohet nga Komisioni i Ekuivalenteve të programeve, i cili përbëhet nga 3 (tre) deri në 5 (pesë) pedagogë të brendshëm të fakultetit që ofron programin ku kërkohen të transferohen kreditet.


Dekani i Fakultetit, bazuar në rregulloren e Institucionit, ngre Komisionin e Transferimeve, i cili brenda dy javësh bën vlerësimin për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga studenti në programin nga i cili kërkon të transferohet, në varësi të përputhjes me programin e studimeve të ofruar nga Albanian University ku kërkon të transferohet studenti duke vendosur pranimin ose jo të kërkesës së tij.

Vlerësimi sipas Standardeve


Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.	Kriteret e pranimit të studentëve janë ndërtuar sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas rregulloreve mësimore të programit të studimit. Fakulteti në fillim të çdo viti ka një javë të ambientimit të studentëve me fakultetin, gjatë të cilit studentit i jepet një informacion i përgjithshëm në lidhje me fakultetin dhe mënyrën e funksionimit të tij.
Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Universiteti ka respektuar kriterin e përgjithshëm të pranimit të studentëve në vitin e parë të studimeve, sipas përcaktimeve në ligjin në fuqi, ku pranohen studentët që



	<p>kanë notën mesatare mbi 6 dhe kanë përfituar njëren nga diplomat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Maturën shtetërore; • Diplomën e shkollës së mesme (të përgjithshme ose të profilizuar, sistemi I vjetër); • Diplomë e shkollës së mesme profesionale 5 vjeçare; • Dëftesa e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlefshme me të në Shqipëri <p>Ndryshimi i kriterit të përgjithshëm të pranimit, të notës mesatare, nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve, ka shënuar një përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së prurjeve të studentëve në këtë program studimi.</p> <p>Kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit BSc në Financë-Bankë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mesatarja e Përgjithshme 70% • Mesatarja e gruplëndëve 30%: <ul style="list-style-type: none"> ○ Ekonomi 15% ○ Matematikë 10% ○ Anglisht 5%
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve (ZKMS) në bashkëpunim të ngushtë me departamentin, është përgjegjëse për orientimin dhe këshillimin e studentëve, duke nisur me informimin e maturanëve mbi programet e studimit të ofruara, dhe deri pas përfundimit të studimeve, nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit (ZKA)</p> <p>Universiteti informon studentët lidhur me procesin e aplikimit, si dhe në fillim të çdo viti të studimeve për organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Forma të tjera informimi janë fletë palosjet, broshurat dhe faqja e internetit e universitetit.</p> <p>Çdo fund semestri, para sezonit të provimeve, studentët plotësojnë një pyetësor elektronik, në të cilin vlerësojnë stafin akademik, stafin administrativ dhe infrastrukturën e vënë në dispozicion të mësimit, nëpërmjet një seri pyetjesh të mirëmenduara. Të dhënat përpunohen dhe i'u bëhen me dije dhe instancave të tjera dhe nëse është e nevojshme merren dhe masat e duhura.</p> <p>Studentët janë të interesuar të dinë fatin e propozimeve dhe të sugjerimeve të tyre, si dhe të informohen për faktin se çfarë veprimesh janë marrë lidhur me sugjerimet dhe propozimet e studentëve. Në këtë kuadër, raportet e këtyre vlerësimeve nga NJSBC publikohen në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p>Universiteti ka Zyrën e Këshillimit të Karrierës, e cila është e lidhur si me tregun e punës ashtu edhe me studentët. Ajo i këshillon studentët për nevojën e përshtatjes së dijeve dhe aftësive të tyre me kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu, një zv/ректор ka përgjegjësi për ceshtjet e studentëve. Kjo formë organizimi shërben për të realizuar këshillimin për</p>



	<p>karrierë dhe për të mbajtur lidhjet e institucionit me të diplomuarit.</p> <p>Përmes zhvillimit të një leksioni të hapur në përfundim të vitit të tretë akademik, studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit, si dhe ju vihet në dispozicion “Udhëzuesi për Zhvillimin e Karrierës”.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna të pjesshme statistikore per numrin e te diplomuarve. Keto te dhena disponohen nga sekretaria mesimore dhe menaxhohen nga kryesekretari. Lidhjet e Departamentit me ish të diplomuarit (ALUMNI) janë rastësore, vetëm në rastet kur student mban vetë kontaktet me departamentin.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna mbi numrin e të regjistruarve, transferuarve dhe të larguarve nga programet e studimit të ciklit të parë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kryesekretarja mesimore i dorezon statistikat perkatese, cdo muaj, ne zyren e statistikave ne MAS. • Sekretaria mesimore nuk e kishte praktikë pune që të evidentonte në regjistrë vlerësimet negative të studentëve, por ato gjurmohen në mënyrë ekstra me dokumenta jashtë rregjistrit <p>Institucioni disponon të dhëna mbi ecurinë e studimeve të tyre, që nga pranimi deri në diplomim. Të dhënat janë të regjistruara në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Notave, në Regjistrin e Diplomave etj. Të dhënat janë edhe në variantin elektronik. Të dhënat statistikore i raportohen MAS dhe Rektoratit.</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Studentët e kanë mundësinë e këshillimit nga Fakulteti dhe universiteti. Departamenti ofron udhëheqje dhe kujdestari për studentët, gjatë gjithë periudhës së studimeve, ndërsa Zyra e Zhvillimit të Karrierës i keshillon për zhvillimin e tyre profesional. Kjo strukturë punon për të realizuar këshillimin për karriere dhe për të mbajtur lidhjet e institucionit me të diplomuarit. Departamenti ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët.</p> <p>Departamenti me mbështetjen e ZKMS orienton studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilën do të zhvillojnë praktikën mësimore. Praktikata mësimore zhvillohen në institucionet me të cilat AUKa marrëveshje bashkëpunimi, ku konkretisht janë 40 institucione me të cilat AU ka marrëveshje të nënshkruara dhe të rregullta. Kryesisht, institucionet janë private apo shoqëri tregtare, të cilat kanë nevojë për student.</p> <p>Gjithashtu, nëse studentët kanë ndonjë sugjerim në lidhje me vendin e zhvillimit të praktikës, institucioni, në përgjithësi, e merr parasysh këtë kërkesë.</p>



Konkluzionet e GVJ

- Niveli më i lartë i notës mesatare në pranimet në universitet ka shënuar një përmirësim të procesit të mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Kjo ka përmirësuar vijueshmërinë dhe cilësinë e procesit dhe realizimit të programit.
- Institucioni ka dokumentacion të mirë që garanton cilësinë e informimit të studentëve lidhur me gjendjen e institucionit, vlefshmërinë e diplomës, mundësitë e kryerjes së praktikës mësimore, mundësitë e punësimit, mundësitë e transferimit të krediteve, etj.
- Institucioni posedon një minimum të dhënash lidhur me punësimin e ish të diplomuarëve (ALUMNI) por gjykojmë se kjo nuk është e plotë dhe se duhet konsoliduar. Të dhëna ekzistojnë vetëm për pjesën e të punësuarve në përputhje me diplomën dhe atyre të punësuarve jo në përputhje me diplomën.
- Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj studentëve, së bashku me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit, të cilat përbëheshin nga 2 personel staf në total, mbetet akoma për tu bërë plotësisht efektive në këshillimin e studentëve, sidomos për periudhën afër përfundimit dhe pas përfundimit të ciklit të studimeve.
- Sekretaria online është duke u përmirësuar dhe modernizuar dhe për momentin ofron shërbime bazike, gjë e cila vështirëson thithjen e informacionit dhe shpejtësinë e shërbimeve ndaj studentëve.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Veprimtari kërkimore-shkencore e Departamentit të Shkencave Ekonomike kryhet në përputhje me Ligjin nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe fokusohet në realizimin e kërkimit shkencor bazë, mbështetjen e veprimtarisë së stafit akademik, në procesin akademik me programe e praktika sipas Kartës së Bolonjës, apo në krijimin e shprehive dhe metodave kërkimore shkencore me studentët.

Përfshirja e pedagogëve në projekte të kërkimit shkencor ka qenë kryesisht individuale në kuadër të projekteve të tyre të doktoraturës ose kërkimin e tyre shkencor, në këto drejtime kryesore:

- Studime dhe botime në revista shkencore brenda e jashtë vendit.
- Pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Kërkimet shkencore në kuadër të kualifikimit për marrjen e gradës Dr. të pedagogëve të brendshëm;
- Përgatitjen e literaturës bazë, për të siguruar cilësi më të lartë;

Njësia kryesore ka organizuar Konferencën Ndërkombëtare me temë “Problemet dhe Sfidat e Transformimit të Shoqërisë Shqiptare drejt Standardeve të Bashkimit Evropian” si dhe nëbashkëpunim me Kolegjin Universitar Qirjazi, konferencën Studentore me temë “Zhvillimi i qëndrueshëm”.

Departamenti gjithashtu ka marrë pjesë në projekte kombëtare apo ndërkombëtare. Në kuadër të këtij angazhimi Departamenti ka fituar një Erasmus+ me Kolegjin Poëislanski në Poloni, nga e cila ka përfituar 1 student nga programi i studimit “BSc në Financë-Bankë” dhe 2 pedagogë nga Kolegji Poëislanski.

Stafi i departamentit është aktivizuar, sipas thirrjeve në projekte të ndryshme gjatë kësaj periudhe duke ofruar konsulencë si ekspertë të shoqërisë civile., etj.

Pedagogët e departamentit janë aktivizuar për zbatimin e “GRADUA” (Erasmus + CBHE) dhe shkrimin e projekteve H2020 (COEXIST & MIGROUTE) apo Erasmus + (Public Finances) si dhe të projekteve që janë aplikuar në thirrje kombëtare (thirrje e CFCU : Student’s perception for EU accession)

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Universiteti dhe Fakulteti edhe për vitet akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 kanë bashkëpunuar me institucione private dhe publike kombëtare dhe ndërkombëtare, kjo përmes memorandumeve të bashkëpunimit apo marrëveshjeve. Shiko Anekse, tabela 20

Këto bashkëpunime i shërbejnë njohjes së eksperiencave të ndryshme në fushën e kërkimit dhe mësimin si njohjes së ndërsjellë të kulturave të vendeve respektive. Më konkretisht këto bashkëpunime synojnë në:

- Konferenca të përbashkëta;
- Shkëmbime akademike;
- Shkëmbimin e pedagogëve dhe studentëve; apo
- Projekte të përbashkëta kërkimore.

Lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës:

Në kuadër të zhvillimit të praktikave mësimore të studentëve, Fakulteti ka arritur bashkëpunime me institucione apo biznese të ndryshme si AK Invest sh.a, Alba Trans sh.p.k, ProCredit Bank, IDRA, AMF, etj.

Megjithatë, ndjekja e praktikave mësimore dhe integrimi i studentëve në institucionet në të cilat ushtrojnë praktikat është i ulët.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Strukturat administrative dhe akademike të institucionit bashkëpunojnë me njëra tjetrën për një mbarëvajtje sa më të mirë të programeve të studimit në kuadër të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare, megjithatë mungesa e ndarjes së pedagogëve në grupe lëndësh të ngjashme, ose të lëndëve të fushave të përafërta, ka dobësuar debatin profesional dhe akademik, shkëmbimin e eksperiencave dhe të konsultimeve në procesin mësimor.</p> <p>Detyrat e stafit janë të përcaktuara qartë në rregulloren e njesisë kryesore dhe në rregulloren e njesisë bazë. Secila zyrë raporton në mënyrë periodike mbi veprimtarinë e kryer në instancat nga të cilat varet, duke garantuar transparencë</p>



	<p>dhe bashkëpunim të frytshëm midis strukturave të institucionit.</p> <p>Bashkëpunimi me institucione të tjera akademike, është garantuar më shumë nëpërmjet ftesës dhe angazhimit në mësimdhënie të pedagogëve të jashtëm, me kontratë, se sa nga veprimtaritë e organizuara direkt nga institucioni.</p> <p>Niveli akademik i pedagogëve të jashtëm të angazhuar vitet e fundit nga institucioni, ka ardhur në rritje.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka disa marrëveshje bashkëpunimi me 9 institucione homologe në rang universiteti si dhe me 25 biznese, në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale. Për programin Financë-Bankë institucioni nuk ka marrëveshje funksionale.</p> <p>Për çdo student, përcaktohet një mbikëqyrës po udhëheqës i praktikës, i cili kontrollon, informon mbi mbarëvajtjen e praktikës si dhe jep vlerësim në fund të këtij procesi.</p> <p>Institucioni nuk organizon trajnime profesionale te metejshme per studentet e tij te diplomuar.</p> <p>Universiteti nuk ka analizuar dhe nuk posedon ndonjë raport të posaçëm, të hollësishëm, për përfitimet nga marrëveshjet kontraktore në fushën që mbulon Departamenti i Shkencave Ekonomike.</p>
<p>Konkluzionet e GVJ</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strukturat administrative dhe akademike të AU bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për një mbarëvajtje sa më të mirë të programeve të studimit, megjithatë ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. • Institucioni bashkëpunon me disa institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda vendit, prej nga vijnë pedagogët dhe stafi me kohë të pjesshme i ftuar për mësimdhënie. • Marrëveshjet e bashkëpunimit të Departamentit të Shkencave Ekonomike me institucione të tjera homologe duhet të shtohet. • Roli dhe përfshirja e Departamentit në projekte zonale, rajonale dhe kombëtare është shumë i ulët dhe duhet të rritet. 	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I DYTË

AU ka plotësuar kryesisht rekomandimet e dhëna nga KA në vendimin për akreditimin e mëparshëm.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Strukturat organizative që ndjekin dhe mbulojnë programin Bachelor në Financë/Bankë, kanë ardhur duke u konsoliduar, janë ristrukturuar në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ato kanë fituar eksperiencën e duhur dhe kanë krijuar një stabilitet që premtan.


2. Elementët përbërës të programit janë të plotë, kurriokulat janë bashkëkohore dhe në tërësinë e vet programi është i krahasueshëm me programet e njëjta të studimit në universitetet dhe shkollat e tjera të larta të vëndit..
3. Në aspektin e rregullimit dhe të funksionimit të procesit mësimor konstatohet një përmirësim i karakterit organizativ dhe funksional.
4. Konstatohet progres në fushën e rritjes së kualifikimeve të stafit akademik me kohë të plotë si dhe të konsolidimit të përvojës së tij akademike dhe pedagogjike.
5. Vihe re dukshëm, një përmirësim cilësor në punën dhe veprimtarinë e Departamentit si njësi bazë që është përgjegjëse për ndjekjen dhe garantimin e zbatimit të programit të studimit Bachelor në Financë dhe Bankë.
6. Cilësia e prurjes së studentëve në këtë program është përmirësuar dhe bashkë me të është rritur edhe mesatarja e notës për studentët e regjistruar në vitin e parë, veçanërisht në dy vitet e fundit.
7. Kushte të mira infrastrukturore dhe mjedise të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie.
8. Ngarkesa relativisht e ulët e numrit të studentëve për një pedagog dhe raportet e mira midis pedagogëve dhe studentëve.
9. Përmirësime të punës me literaturën dhe me angazhimin e stafit akademik, qoftë edhe në mënyrë të individualizuar, në veprimtari të karakterit shkencor dhe kërkimor.

b. Pika të dobëta:

1. Paqëndrueshmëria e stafit, veçanërisht atij me kohë të plotë, por edhe të të stafit me kontratë, cënon cilësinë e mësimdhënies dhe nuk garanton qëndrueshmërinë.
2. Në institucion ka zyra, të cilat janë të angazhuara edhe me këtë program studimi, të cilat konsiderohen si me funksione fare formale, sa për aparence. Grupet e vlerësimit të cilësisë dhe sistemi i kontrollit të cilësisë nuk është gjithnjë funksional.
3. Në Departament dhe në Fakultet, nuk funksionojnë plotësisht grupet mësimore dhe grupet e lëndëve, të cilat e bëjnë më efektiv procesin e mësimdhënies dhe rritin nivelin akademik dhe profesional të stafit.
4. Angazhimi i pedagogëve të Departamentit në veprimtarinë kërkimore dhe shkencore ka qënë i ulët. Mungojnë projektet kërkimore institucionale si Departament. Veprimtaria shkencore është rastësore dhe individuale.
5. Edhe pse institucioni ka infrastrukturë të mjaftueshme për procesin mësimdhënës dhe mësimnxënës, një pjesë e saj, veçanërisht labororet dhe paisjet informatike nuk janë të lira të përdoren prej studentëve për punët e tyre të pavarura dhe detyrimet e tjera jashtë orës së mësimi.

c. Mundësitë:

1. Fakulteti dhe Departamenti kanë mundësi më të mira për të zgjeruar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e eksperiencës me Departamente homologe, brënda dhe jashtë vëndit.
2. Departamenti dhe Fakulteti kanë mundësi që të anashkalojnë procedurat gati formale të reflektuar në disa raste për rekrutimin e stafit të ri akademik. Po kështu institucionet kane mundësi të evitojnë përfshirjen e stafit administrativ në procesin mësimdhënës.
3. Mundësi më të mira për të analizuar kërkesat e tregut dhe për të ndjekur ecurinë e rrjetit të të diplomuarëve ndër vite (ALUMNI).
4. Institucioni ka mundësi që të përmirësojë ndjekjen dhe realizimin efektiv të praktikave mësimore të studentëve. Ngarkesa e ulët e numrit mesatar të studentëve për një pedagog efektiv, krijon mundësi shumë të mira që të rritet cilësia e praktikave mësimore.



5. Mundësi për të organizuar kualifikimin profesional të vazhduar në fushën e financës dhe të bankës.

d. Pengesat:

1. Në këtë program studimi ka një ofertë konkurruese që vjen përditë dhe në rritje dhe që përbën në vetvete një vështirësi serioze.
2. Edhe për këtë program studimi ka mjedis që nuk është shumë inkurajues dhe as agresiv, është indiferent dhe që legjislacioni nuk është i kompletuar për të garantuar institucionalisht mirëfunksionimin e praktikave mësimore apo të partneriteteve.

Rekomandime:

Grupi i ekspertëve të jashtëm rekomandon:

1. Të bëhen përpjekje për të konsoliduar stafin akademik, për të evituar lëvizjet e shpeshta të tij dhe për të fituar qëndrueshmërinë e stafit, që ndikon në imazhin dhe të ardhmen e institucionit dhe të programit të studimit.
2. Kontrolli i cilësisë duhet të bëhet më funksional, dhe më konkret. Anketat, studimet dhe rastet e evidentuara nga zyrat që ndjekin cilësinë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies, duhet të përdoren fort për të krijuar klimën e nevojshme.
3. Në Departament dhe në Fakultet, duhet të funksionojnë plotësisht grupet mësimore dhe grupet e lëndëve, të cilat e bëjnë më efektiv procesin e mësimdhënies si dhe rritin nivelin akademik dhe profesional të stafit.
4. Departamenti duhet të angazhohet dhe të përfshihet institucionalisht në projekte kërkimore dhe shkencore të cilat të konceptohet si veprimtari që rrokin angazhimin e gjithë stafit akademik..
5. Labororet dhe paisjet informatike duhet të vihen në dispozicion të studentëve për punët e tyre të pavarura dhe detyrimet e tjera jashtë orës së mësimin.

ANALYSIS OF THE STUDY PROGRAM EVALUATION

I. AU has substantially fulfilled the recommendations given by the AC in its previous accreditation decision.

II. SWOT ANALYSIS OF THE EXTERNAL ESTIMATION TEAM (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS)

a. Strengths:

1. Organizational structures, that support and cover the Bachelor program in Finance/Banking, are becoming more solid. They have also been restructured in order to improve the quality of teaching and learning. They have gained the right experience and have created a promising stability.
2. The components of the program are complete, the curricula are contemporary and the program, as a whole, is comparable to the same study programs at other universities in the country.
3. In terms of the regulation and functioning of the learning process, it is noted that the organizational and functional aspects are improved.
4. The full-time academic staff has shown progress in becoming more qualified and improving their academic and pedagogical expertise.

5. It is noticed that, there is a qualitative improvement in the work and activity of the Department, as the basic unit responsible for pursuing and ensuring the implementation of the Finance and Banking Bachelor study program.
6. The quality of the students enrolled in the program is improved, which has led to the increasing of the average grade of the first-year students of this program, especially in the last two years.
7. Good infrastructure conditions and suitable teaching and learning environments.
8. The low student load per lecturer and the good relationship between lecturers and students.
9. Improved literature and increased engagement, also in an individualized way, on the scientific and research activities by the academic staff.

b. Weaknesses:


1. The volatility of the academic staff, especially of the full-time staff as well as of the contracted staff, affects the quality of teaching and lacks the proper sustainability.
2. There are structures involved in this study program, that do exist, but they lack the proper functioning. The same occurrence is noted in the quality assessment teams and quality control systems.
3. Teaching and subject groups are established in the Faculty and in Department, in order to increase the effectiveness of the teaching and the academic and professional skills of the staff, but they lack the proper functioning.
4. The engagement of the Department lecturers in research and scientific activities is very low. There are not carried out institutional research projects, realized by the whole Department as a group. Scientific activity is mainly random and individual.
5. Even though the institution possesses the sufficient spaces and infrastructure for the teaching and learning process, some of it, especially the laboratories and the IT equipments, are not available to be used by the students in order to work independently and accomplish other off-duty assignments.

c. Opportunities:

1. The Faculty and the Department have good opportunities to expand the collaboration and to exchange the experience with the counterpart Departments, inside and outside the country.
2. The Department and Faculty have the ability to bypass the nearly formal procedures reflected in some cases for the recruitment of new academic staff. Furthermore, the institutions have also the ability to avoid the involvement of the administrative staff in the teaching process.
3. Better opportunities on analyzing the market's demands and evaluating the progress of the performance for the graduates over the years (ALUMNI).
4. The institution has the ability to improve the effectiveness of the pursuance and realization of the students' teaching practices. The low workload of the average number of students per lecturer creates very good opportunities to increase the quality of teaching practices.
5. Opportunities to organize continuous professional qualifications in the Finance and Banking areas.

d. Threats:

1. There is a competitive supply in this study program, which is increasing in daily basis and which presents a serious difficulty in itself.
2. Even for this study program, the environment is neither very encouraging nor aggressive. It is indifferent. The legislation is incomplete to institutionally guarantee the proper functioning of teaching practices or partnerships.



Recommendations:

External Estimation Team recommends that:

1. More efforts to consolidate the academic staff, to avoid its frequent movement and to reach the stability of staff, which affects in the image and the future of the institution and study program.
2. Quality control needs to become more functional and concrete. Surveys, studies and cases identified by the offices that monitor the quality of teaching and learning should be strongly used to create the necessary environment.
3. In the Department and also Faculty, the teaching and subject groups should be fully operational, which will lead to a more effective teaching process and increase the academic and professional skills of the staff.
4. The department should be institutionally engaged and involved in research and scientific projects that are designed as activities that capture the engagement of all academic staff.
5. Laboratories and computing equipments must be accessible for students, so they can work independently and accomplish other out-of-class obligations.

External Estimation Team:

1. **Prof. Dr. Sherif BUNDO**
2. **Dr. Dritan FINO**

